



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 601/ 10 prot.

Datë 02/04/2026

V E N D I M

Nr. 456/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 02/04/2026, shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me vlerësimin me pikë të propozimeve teknike dhe të paraqitura nga operatori ekonomik “4 S” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me numër reference Nr. REF-67406-10-31-2025, me objekt: “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Njësinë Speciale për Kufirin dhe Emigracionin”, me fond limit 119.232.710 (njëqind e njëmbëdhjet million e dyqind e tridhjet e dy mijë e shtatëqind e dhjetë) lekë pa TVSH ose 1.231.361,25 (një million e dyqind e tridhjet e një mijë e treqind e gjashtëdhjet e një presje njëzet e pesë) euro ps TVSH, Loti 1, me numër reference Nr. REF-67408-10-31-2025, me objekt të lotit: “Gatim dhe shpërndarje ushqimi për Njësinë e Sigurisë Publike Tiranë” me fond limit të lotit 76.903.340 (shtatëdhjetë e shtatë million e nëntëqind e tre mijë e treqind e dyzet) lekë pa TVSH ose 794.209,85 (shtatëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e dyqind e nëntë presje tetëdhjet e pesë) euro pa TVSH, zhvilluar me datë 30.01.2026, nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara SHA.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me vlerësimin me pikë të propozimeve teknike dhe

ekonomike të paraqitura nga operatori ekonomik “*DRIVE EXPERT ALBANIA*” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me vlerësimin me pikë të propozimeve teknike dhe ekonomike të paraqitura nga operatori ekonomik “*DION-AL*” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit..

Ankimues:

Operatori ekonomik “4 S” SHPK me NIPT: L64425401K dhe me adresë: Lagjja “Xhevdet Nepravishta”, Rruga “Qerim Arapi”, Zona Kadastrale 8571, Godina 196, Pasuria nr.23/104-N4, Lushnje, Fier.

Autoriteti Kontraktor:

*Operatori i Blerjeve të Përqëndruara SHA
Adresa: Rruga “Reshit Çollaku”, godina nr.6/337 (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë.*

Subjekt i interesuar:

Operatori ekonomik “DRIVE EXPERT ALBANIA” SHPK me NIPT: L72017021O dhe me adresë: Njësia Bashkiake nr.7, Bulevardi “Gjergj Fishta”, Zona kadastrale 8220, Pallati “G&P”, Kati I, Tiranë.

Operatori ekonomik “DION-AL” SHPK me NIPT: K67917301H dhe me adresë: Bulevardi “Gjergj Fishta”, kulla 2, kati 2, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V e r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 03.11.2025 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me numër reference Nr. REF-67406-10-31-2025, me objekt: “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Njësinë Speciale për Kufirin dhe Emigracionin”, me fond limit 119.232.710 (njëqind e njëmbëdhjet million e dyqind e tridhjet e dy mijë e shtatëqind e dhjetë) lekë pa TVSH ose 1.231.361,25 (një million e dyqind e tridhjet e një mijë e treqind e gjashtëdhjet e një presje njëzet e pesë) euro pa TVSH, Loti 1, me numër reference Nr. REF-67408-10-31-2025, me objekt të lotit: “Gatim dhe shpërndarje ushqimi për Njësinë e Sigurisë Publike Tiranë” me fond limit të lotit 76.903.340 (shtatëdhjetë e shtatë million e nëntëqind e tre mijë e treqind e dyzet) lekë pa TVSH ose 794.209,85 (shtatëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e dyqind e nëntë presje tetëdhjet e pesë) euro pa TVSH, zhvilluar me datë 30.01.2026, nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara SHA.

II.2. Në datë 30.01.2026 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 11.02.2026 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

1	"DION-AL" SHPK	me ofertë	54.508.410	leke	282	pikë	kualifikuar
2	"4 S" SHPK	me ofertë	50.004.375	leke	261	pikë	kualifikuar
3	"DRIVE EXPERT ALBANIA" SHPK	me ofertë	56.830.050	leke	224,55	pikë	kualifikuar

II.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronik konstatohet, se në datën 17.02.2026 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit paraprak për procedurën e mësipërme të prokurimit, duke shpallur fitues operatorin ekonomik "DION-AL" SHPK.

II.5. Në datën 25.02.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6362 datë 25.02.2026, dhe me numër protokoll nr. 601/2026 prot, datë 25.02.2026 e operatorit ekonomik "4 S" SHPK, me anë të së cilës kundërshtohet vendimmarrja e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi vlerësimin me pikë të propozimeve teknike të paraqitura nga operatorët ekonomikë të kualifikuar dhe konkretisht të propozimit teknik të operatorit ekonomik "4 S" SHPK, të propozimit teknik të operatorit ekonomik "DRIVE EXPERT ALBANIA" SHPK dhe të propozimit teknik të operatorit ekonomik "DION-AL" SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Në përputhje me nenin 112 "Veprimet paraprake" të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 601/1, datë 26.02.2026 lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "4 S" SHPK, mbi kundërshtimin e vendimmarrjes së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi vlerësimin me pikë të propozimeve teknike të paraqitura nga operatorët ekonomikë të kualifikuar dhe konkretisht të propozimit teknik të operatorit ekonomik "4 S" SHPK, të propozimit teknik të operatorit ekonomik "DRIVE EXPERT ALBANIA" SHPK dhe të propozimit teknik të operatorit ekonomik "DION-AL" SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.7. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik "DION-AL" SHPK sipas parashikimeve të nenit 113, të ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave ka paraqitur argumente me numër argumenti elektronik C/2026/864, datë 27.02.2026 si subjekt i interesuar, argumente të cilat janë protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 601/2 prot., datë 02.03.2026.

II.8. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik ankimues "4 S" SHPK me shkresën "Paraqitja e argumentave për ankesën me nr aplikimi A/2026/6362, me objekt: Loti 1: "Gatim dhe shpërndarje ushqimi për Njësinë e Sigurisë Publike Tiranë", REF-67408-10-31-2025" e datës 04.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 601/3 prot, datë 04.03.2026 ka paraqitur argumenta shtesë për pretendimet e parashtruara në ankesën me numër ankimi elektronik A/2026/6362 datë 25.02.2026 e operatorit ekonomik ankimues "4 S" SHPK për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.9. Në datë 05.03.2026, autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresën nr. 3624/20 prot, datë 05.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 601/4 prot, datë 05.03.2026, ku është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, “Vendim KSHA 38/2026”, datë 05.03.2026, për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “4 S SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit.

II.10. Me shkresën nr. 3624/20 prot, datë 05.03.2026 “Mbi shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “4 S” shpk, lidhur me vlerësimin në procedurën e prokurimit me nr. REF-67408-10-31-2025, me objekt: Loti 1 ‘Gatim dhe shpërndarje ushqimi për Njësinë e Sigurisë Publike Tiranë.’” protokolluar me tonën me nr. 601/5 prot, datë 09.03.2026, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, “Vendim KSHA 38/2026”, datë 05.03.2026, për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “4 S” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit.

II.11. Me shkresën nr. 601/6 prot., datë 09.03.2026 me objekt “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “4 S” SHPK”, Komisioni i Prokurimit Publik me qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur ka kërkuar nga autoriteti kontraktor që të dërgojë procesverbalin e vlerësimit të ofertave të paraqitura i mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në datë 11.02.2026.

II.12. Me shkresën nr. 3624/22 prot, datë 06.03.2026 me objekt “Dërgim dokumentacioni” protokolluar me tonën me nr. 601/7 prot, datë 13.03.2026, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, procesverbalin e vlerësimit të ofertave të paraqitura i mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në datë 11.02.2026.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “4 S” SHPK, për skualifikimin e ofertës së tij me arsyen, si në vijim: “Pasi u njohëm me formularin e njoftimit të operatorëve ekonomikë të suksesshëm në marrëveshjen kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit, shoqëria jonë vlerëson se renditja e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë është e padrejtë dhe në vlerësim jo objektiv të kapaciteteve dhe kualifikimeve reale të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës. Në kriterin e vlerësimit të çmimit vërejmë se shoqëria jonë ka një diferencë të ndjeshme në çmim kundrejt 2

pjesëmarrësve të tjerë duke u vlerësuar në mënyrë automatike me pikët maksimale që mund të jepen për këtë kriter, pra $75 \text{ pikë} * 3 = 225 \text{ pikë}$.

Ndërkohë referuar mënyrës së llogaritjes së pikëve sipas formulës:

...

Rezulton se pikët e ofertuesve të tjerë janë: $50,004,375 * 75 / 54,508,410 = 68.8 \text{ pikë} * 3 = 206.4 \text{ pikë}$ për operatorin DION-AL dhe $50,004,375 * 75 / 56,830,050 = 65.99 \text{ pikë} * 3 = 197.97 \text{ pikë}$ për operatorin DRIVE EXPERT ALBANIA. Është shumë e paqartë dhe jo transparente për ne se si mund të përmbysin kriteret e tjera të vlerësimit një diferencë të tillë pikësh, për më tepër për kriterin kryesor të vlerësimit që është çmimi.

Në pikën 4.4 të DST Kriteret e përzgjedhjes së fituesit përcaktohet ndër të tjera:

Kriteri:

1. Çmimi 75 pikë

2. Kuafikimi dhe përvoja e stafit (Kryekuzhinier dhe kuzhinier) [0- 25] pikë

2.1 Kuafikimi dhe përvoja e Kryekuzhinierit: [0- 15] pikë, e ndarë:

a. Kualifikimi profesional: 0- 5 pikë

...

Së pari mënyra e llogaritjes së pikëve sipas formulës së mësipërme rezulton të jetë e gabuar dhe që nuk llogarit në mënyrë të saktë pikët e secilit operator pjesëmarrës. Në këtë rast për referencë gjykojmë se duhet të meret Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet dhe jo Vminkl Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet, ndryshe nga mënyra e vlerësimit për kriterin e çmimit.

Nga ana tjetër kërkojmë rivlerësimin për këtë kriter pasi punonjësi i paraqitur prej nesh si kryekuzhinier z. D D është i pajisur me të paktën 9 kualifikime:

...

Pra në kuptim të kërkesës së mësipërme KVO nuk mund të bazohet në numrin fizik të CERTIFIKATAVE të paraqitura, por në numrin e KUALIFIKIMEVE të konstatuara. Çertifikata e lëshuar nga Qendra e Formimit Profesional Jopublik RoyalCert Albania Academy për z. D D është e një rëndësie të veçantë pasi është një kurs me kohëzgjatje disa mujore, përmban të paktën 7 lloje kualifikimesh për tema të cilat lidhen me fushën e ushqimit, dhe më e rëndësishmja Autoriteti Kombëtar i Ushqimit si organi kompetent në fushën e ushqimit në Shqipëri e njuh këtë certifikatë si të njëvlefshme me dëshmi kualifikimi ose diplomë që mund të paraqitet nga drejtuesi teknik i firmës në rast aplikimi për licencim me kodin II.1.A.1. Referuar sa më sipër kjo certifikatë nuk mund të baraspeshohet le të themi në kuptimin e drejtëpërdrejtë me 1 ÇERTIFIKATË MIRËNJOHJE NË FUSHËN E GATIMIT sikurse mund të kenë paraqitur operatorët e tjerë pjesëmarrës, por duhet të trajtohet si një certifikatë e cila përmban minimalisht 7 kualifikime.

Kërkojmë që metoda e vlerësimit për këtë kriter mbi shoqërinë tonë të bazohet mbi numrin e 9 kualifikimeve në total.

b. Përvoja (Eksperienca) e kryekuzhinierit 0- 10 pikë

...

Së pari mënyra e llogaritjes së pikëve sipas formulës së mësipërme rezulton të jetë e gabuar dhe që nuk llogarit në mënyrë të saktë pikët e secilit operator pjesëmarrës. Në këtë rast për referencë gjykojmë se duhet të meret Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet dhe jo Vminkl _____ Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet, ndryshe nga mënyra e vlerësimit për kriterin e çmimit.

Kërkojmë rivlerësimin e kriterit si më sipër pasi shoqëria jonë ka paraqitur Kryekuzhinier me të paktën 10 vite përvojë pune. Një përvojë e tillë tregon se individ i ka kaluar gjithë ciklin e zhvillimit profesional, duke zotëruar aftësitë në menaxhimin operacional dhe koordinim, eksperiencë në përballimin e volumit të madh të gatimit të racioneve, cilësinë e shërbimit, reduktimin e gabimeve në procesin e përgatitjes dhe shpërndarjes, menaxhimin efektiv të situatave të emergjencës, metodat inovative në gatim dhe mbi të gjitha zotëron raportin më të mirë PËRVOJË dhe ENERGIJË pune duke iu referuar moshës relativisht të re të punonjësit të paraqitur.

Kërkojmë vlerësimin me pikët maksimale për shoqërinë tonë lidhur me këtë kriter.

2.2 Kualifikimi dhe përvoja e Kuzhinierit:

[0- 10] pikë, e ndarë:

a. Kualifikimi profesional:

0- 5 pikë

...

Së pari mënyra e llogaritjes së pikëve sipas formulës së mësipërme rezulton të jetë e gabuar dhe që nuk llogarit në mënyrë të saktë pikët e secilit operator pjesëmarrës. Në këtë rast për referencë gjykojmë se duhet të meret Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet dhe jo Vminkl _____ Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet, ndryshe nga mënyra e vlerësimit për kriterin e çmimit.

Nga ana tjetër kërkojmë rivlerësimin për këtë kriter pasi punonjësi i paraqitur prej nesh si kuzhinier znj. E F S është i pajisur me të paktën 9 kualifikime: Çertifikatë për kursin e unifikuar Kuzhinë përfunduar në vitin 2022, Çertifikatë kualifikimi per Specialist i sigurisë ushqimore dhe metodave H.A.C.C.P, si dhe Çertifikatë për kursin profesional: 1- Siguria ushqimore; 2- Cilësia ushqimore; 3- Teknologjitë ushqimore; 4- Baza ligjore për OBU-të; 5- Kërkesat e HACCP-it; 6- Praktikat e mira të punës /PMP; 7- Praktikat e mira të higjienës / PMH.

Referuar kërkesave të DST mbi metodën e vlerësimit të këtij kriteri: Metoda e verifikimit: Komisioni i vlerësimit do të mbështetet në dokumentet e dorëzuara nga operatori ekonomik. Pikët do të jepen në mënyrë proporcionale sipas numrit të kualifikimeve të vlefshme të konstatuara.

Pra në kuptim të kërkesës së mësipërme KVO nuk mund të bazohet në numrin fizik të ÇERTIFIKATAVE të paraqitura, por në numrin e KUALIFIKIMEVE të konstatuara. Çertifikata e lëshuar nga Qendra e Formimit Profesional Jopublik RoyalCert Albania Academy për znj. E F S është e një rëndësie të veçantë pasi është një kurs me kohëzgjatje disa mujore, përmban të paktën 7 lloje kualifikimesh për tema të cilat lidhen me fushën e ushqimit, dhe më e rëndësishmja Autoriteti Kombëtar i Ushqimit si organi kopetent në fushën e ushqimit në Shqipëri e njeh këtë certifikatë si të njëvlefshme me dëshmi kualifikimi ose diplomë që mund të paraqitet nga drejtuesi teknik i firmës në rast aplikimi për licencim me

kodin II.1.A.1. Referuar sa më sipër kjo certifikatë nuk mund të baraspeshohet le të themi në kuptimin e drejtëpërdrejtë me 1 CERTIFIKATË MIRËNJOHJE NË FUSHËN E GATIMIT sikurse mund të kenë paraqitur operatorët e tjerë pjesëmarrës, por duhet të trajtohet si një certifikatë e cila përmban minimalisht 7 kualifikime.

Kërkojmë që metoda e vlerësimit për këtë kriter mbi shoqërinë tonë të bazohet mbi numrin e 9 kualifikimeve në total.

b. Përvoja (Eksperiencia) e kuzhinierit

0- 5 pikë

...

Së pari mënyra e llogaritjes së pikëve sipas formulës së mësipërme rezulton të jetë e gabuar dhe që nuk llogarit në mënyrë të saktë pikët e secilit operator pjesëmarrës.

Në këtë rast për referencë gjykojmë se duhet të meret Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet dhe jo Vminkl _____ Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet, ndryshe nga mënyra e vlerësimit për kriterin e çmimit.

Kërkojmë rivlerësimin e kriterit si më sipër pasi shoqëria jonë ka paraqitur Kuzhinier me të paktën 4 vite përvojë pune. Një përvojë e tillë tregon se individi ka kaluar gjithë ciklin e zhvillimit profesional, duke zotëruar aftësitë në menaxhimin operacional dhe koordinim, eksperiencë në përballimin e volumit të madh të gatimit të racioneve, cilësinë e shërbimit, reduktimin e gabimeve në procesin e përgatitjes dhe shpërndarjes, menaxhimin efektiv të situatave të emergjencës, metodat inovative në gatim dhe mbi të gjitha zotëron raportin më të mirë PËRVOJË dhe ENERGJI pune duke iu referuar moshës relativisht të re të punonjësit të paraqitur.

Kërkojmë vlerësimin me pikët maksimale për shoqërinë tonë lidhur me këtë kriter.

Në përfundim, kërkojmë rivlerësimin e pikëve të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës dhe vlerësimin me pikët maksimale të shoqërisë tonë për të gjitha kriteret e vlerësimit.”,

Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në Seksionin 4 “Procedura”, pika 4.4 “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit” të dokumenteve të tenderit të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriteret e përzgjedhjes së fituesit, si më poshtë:

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) **Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X**

Shpërndarja e pikëve, per cdo Lot si më poshtë:

Kriteri:

1. Çmimi 75 pikë
2. Kuafikimi dhe përvoja e stafit (Kryekuzhinier dhe kuzhinier) [0- 25] pikë

- Për vlerësimin e ofertës ekonomisht më të favorshme do të shërbejnë dokumentat e paraqitur në sistem si: oferta sipas shtojcës 1 dhe 2 dhe Dokumentat e kërkuara për kryekuzhinierin dhe kuzhinierin si: diploma, certifikata, cv, certifikime, kontratat e punës, etj.

Argumentimi i kriterëve të pikezuara dhe menyra e llogaritjes së pikeve:

1. Çmimi:

75 pikë

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$Pk1 = Vmink1 \times Pmaxk1 / Ok1$

$Pk1$ _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

$Vmink1$ _____ Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet

$Pmaxk1$ _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

$Ok1$ _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

2. Kualifikimi dhe përvoja e stafit (Kryekuzhinier dhe kuzhinier) [0- 25] pikë,

Argumentim: Vlerësimi me pikë për **kualifikimin profesional** dhe **përvojën e punës** është vendosur për të siguruar një diferencim real të cilësisë së ofruar nga ofertuesit, në një shërbim që ndikon drejtëpërdrejtë në shëndetin dhe mirëqënien e forcave të njësisë publike dhe njësisë speciale, përfitues të shërbimit objekt prokurimi.

Ky sistem vlerësimi synon një vlerësim proporcional, duke vlerësuar me pikë më shumë ofertuesit që disponojnë staf më të kualifikuar dhe me përvojë më të gjatë, si dhe garanton cilësi më të lartë të shërbimit gjatë zbatimit të kontratës.

Stafi Teknik i kualifikuar (veçanërisht kryekuzhinieri dhe kuzhinieri) është në gjendje të zbatojë me përpikmëri legjislacionin për sigurinë ushqimore, duke siguruar çdo proces nga magazinimi deri të shpërndarja. Kryekuzhinierët dhe kuzhinierët me arsim profesional dhe trajnime të vazhdueshme sjellin metoda bashkëkohore gatimi, efikasitet dhe menaxhim më të mirë të burimeve ushqimore, e cila përkthehet në cilësi më të mirë ndaj përfituesve.

Përvoja profesionale e stafit, veçanërisht e kryekuzhinierit dhe kuzhinierit është një tregues i drejtëpërdrejtë i cilësisë reale të shërbimit, objekt prokurimit, stabilitetit operacional dhe menaxhimit të riskut në ofrimin e shërbimit. Përvoja e gjatë ndihmon në aftësimin për koordinimin e stafit të kuzhinës, ndarjen e detyrave dhe ruajtjen e ritmit të punës, sidomos në ambiente me intensitet të lartë pune, me orare të mirëpërckatuara dhe norma dietike të përckatuara.

Detajimi i pikëzimit është si më poshtë:

2.1 Kualifikimi dhe përvoja e Kryekuzhinierit:

[0- 15] pikë, e ndarë:

a. Kualifikimi profesional:

0- 5 pikë

Kërkimi i diplomës profesionale siguron përmbushjen e nivelit minimal arsimor për ushtrimin e profesionit, ndërsa përfshirja e kualifikimeve shtesë për stafin Teknik, përkatësisht për kryekuzhinierin, në kriteret e vlerësimit siguron përzgjedhjen e operatorëve që kanë nivel më të lartë ekspertize, përvojë të avancuar praktike dhe njohuri të përditësuar mbi sigurinë dhe cilësinë ushqimore.

Kualifikimet (trajnime, certifikime higjieno-sanitare, trajnime HACCP, etj.) tregojnë që personi është përditësuar me praktikatat moderne dhe standardet aktuale të industrisë ushqimore.

Kualifikimet lidhen drejtpërdrejt me cilësinë aktuale të shërbimit, pasi një profesionist me trajnime të fundit është më i aftë të aplikojë metoda efikase, të sigurta dhe inovative të gatimit, duke ndikuar në cilësinë, dhe sigurinë e ushqimit që ofrohet.

Kriteri vlerësohet në mënyrë proporcionale në bazë të numrit të kualifikimeve të dokumentuara, pavarësisht objektit të tyre të detajuar, me kusht që të jenë të lidhura me profesionin e kryekuzhinierit dhe fushat ndihmëse (ushqim, higjienë, siguri ushqimore, menaxhim kuzhine, planifikim menuje, etj.).

Metoda e verifikimit: Komisioni i vlerësimit do të mbështetet në dokumentet e dorëzuara nga operatori ekonomik. Pikët do të jepen në mënyrë proporcionale sipas numrit të kualifikimeve të vlefshme të konstatuara.

Dokumentet për verifikim:

Certifikata profesionale/trajnime që lidhen me zbatimin e standarteve kombëtare e ndërkombëtare, higjienën dhe sigurinë ushqimore, teknika praktike gatimi, menaxhim kuzhine, teknologjia ushqimore dhe inovacionet në gatim, ndërgjegjësime për mjedisin dhe qëndrueshmërinë, etj., apo cdo dokument tjetër që provon kualifikime/trajnime në fusha që lidhen me profesionin e kryekuzhinierit dhe objektin e prokurimit, të lëshuara nga organe të akredituara/të njohura kombëtare apo ndërkombëtarisht.

Vlerësimi do të bëhet si më poshtë:

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$Pk1 = Vmink1 \times Pmaxk1 / Ok1$

$Pk1$ _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

$Vmink1$ _____ Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet

$Pmaxk1$ _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

$Ok1$ _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

b. Përvoja (Eksperienca) e kryekuzhinierit

0- 10 pikë

Argumentimi:

Përvoja profesionale e kryekuzhinierit është një tregues thelbësor i aftësisë për të garantuar cilësinë dhe sigurinë ushqimore gjatë zbatimit të kontratës. Roli i kryekuzhinierit nuk kufizohet vetëm në gatim, por përfshin organizimin e procesit të gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit, menaxhimin e stafit të kuzhinës, hartimin dhe zbatimin e menuve ditore në përputhje me kërkesat dhe normat e përcaktuara nga AK, zbatimin e sistemit HACCP dhe standarteve të higjienës ushqimore, planifikimin e furnizimeve dhe mbikëqyrjen e sasisë dhe cilësisë së produkteve ushqimore.

Përvoja mbi 5 vite tregon që individi ka kaluar gjithë ciklin profesional të një zhvillimit të njëkuzhinieri drejt nivelit të kryekuzhinierit, duke zotëruar aftësitë në menaxhimin

operacional dhe koordinim, eksperiencë në përballimin e volumit të madh të gatimit të racioneve, njohuri të konoliduara mbi standartet higjienike dhe të sigurisë. Në shërbime me natyrë të vazhdueshme dhe të ndjeshme si gatimi për institucione të sigurisë publike, përvoja e gjatë kontribuon drejtëpërdrejtë në stabilitetin dhe cilësinë e shërbimit, reduktimin e gabimeve në procesin e përgatitjes dhe shpërndarjes, menaxhimin efektiv të situatave të emergjencës.

Cilësia e ushqimit dhe respektimi i standarteve të sigurisë ushqimore varen nga ekspertiza praktike dhe menaxheriale e kryekuzhinierit.

Metoda e verifikimit:

Eksperienca minimale në punë të ngjashme për kryekuzhinierin është 5 vite, vite të vlerësuara si përvojë minimale e domosdoshme për të garantuara menaxhimin bazë të kuzhinës. Një eksperiencë e tillë siguron stabilitet dhe njohuri mbi proceset e gatimit. Nëse kjo eksperiencë është 5 vite ose më pak, oferta nuk merr asnjë pikë.

Me 10 pikë do të vlerësohen ofertuesit të cilët do të dëshmojnë se kanë në stafin e tyre kryekuzhinier me përvojën më të lartë, sepse përvoja më e lartë në punë tregon rritje profesionale, ekspertizë të konsoliduar dhe aftësi në optimizimin e proceseve të punës.

Ofertuesit e tjerë vlerësohen sipas formulës në rend zbritës.

Dokumentet për verifikim:

Për të përmbushur këtë kërkesë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Librezë pune/ deklaratë e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ cv dhe/ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton ekspseriencën në shërbime të ngjashme.

Vlerësimi do të bëhet si më poshtë:

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$P_{k1} = V_{mink1} \times P_{maxk1} / Ok1$

P_{k1} _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

V_{mink1} _____ Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet

P_{maxk1} _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

$Ok1$ _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

2.2 Kuafikimi dhe përvoja e Kuzhinierit: [0- 10] pikë, e ndarë:

a. Kualifikimi profesional: 0- 5 pikë

Kualifikimi profesional:

Kriteri i kualifikimit profesional për kuzhinierin synon të vlerësojë aftësinë praktike, përgatitjen teknike dhe njohuritë shtesë të personit që do të jetë përgjegjës për përgatitjen e përditshme të ushqimit. Ky kriter nuk lidhet me diplomën profesionale (e cila është kërkesë minimale për t'u kualifikuar), por me trajnimet, dhe përditësimet profesionale që ndikojnë drejtëpërdrejt në cilësinë e gatimit dhe në sigurinë ushqimore. Kualifikimet e vazhdueshme garantojnë zbatim të saktë të standardeve higjieno-sanitare në praktikë.

Trajnimet mbi higjienën ushqimore, temperaturat e ruajtjes, menaxhimin e produkteve dhe ndarjen e ushqimeve të papërpunuara nga ato të gatuar, apo trajnime/kualifikime të tjera që

lidhen me objektin e prokurimit janë jetike për parandalimin e ndotjeve dhe mbajtjen e cilësisë ushqimore, ndihmojnë në përmirësimin e teknikave të gatimit dhe efikasitetit të punës. Kualifikimet në teknika moderne gatimi, përdorim të pajisjeve profesionale, dhe përgatitje dietetike e bëjnë kuzhinierin më efikas dhe e ndihmojnë të përgatisë ushqim në mënyrë të shpejtë, të shëndetshme dhe me standard të qëndrueshëm.

Kualifikimet shtesë për kuzhinierin janë një tregues për aftësinë e tij në përgatitjen e vakteve sipas sasive dhe kalorive të përcaktuara në specifikimet teknike.

Kualifikimet tregojnë që kuzhinieri jo vetëm zotëron profesionin, por edhe zhvillon aftësitë e tij në mënyrë të vazhdueshme, duke garantuar që shërbimi të mbetet brenda standarteve ushqimore, edhe në kushte pune me volum të lartë ose dinamikë të ndryshme.

Kriteri vlerësohet në mënyrë proporcionale në bazë të numrit të kualifikimeve të dokumentuara, pavarësisht objektit të tyre të detajuar, me kusht që të jenë të lidhura me profesionin e kuzhinierit dhe fushat ndihmëse (ushqim, higjienë, siguri ushqimore, menaxhim kuzhine, etj.).

Metoda e verifikimit: Komisioni i vlerësimit do të mbështetet në dokumentet e dorëzuara nga operatori ekonomik. Pikët do të jepen në mënyrë proporcionale sipas numrit të kualifikimeve të vlefshme të konstatuara.

Dokumentet për verifikim:

Certifikata profesionale/trajtime që lidhen me gatimin profesiona, zbatimin e standarteve kombëtare e ndërkombëtare, higjienën dhe sigurinë ushqimore, teknika praktike gatimi, teknologjia ushqimore dhe inovacionet në gatim, ndërgjegjësime për mjedisin dhe qëndrueshmërinë, etj., apo cdo dokument tjetër që provon kualifikime/trajtime në fusha që lidhen me profesionin e kryekuzhinierit dhe objektin e prokurimit, të lëshuara nga organe të akredituara/të njohura kombëtare apo ndërkombëtarisht.

Vlerësimi do të bëhet si më poshtë:

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$$Pk1 = Vmink1 \times Pmaxk1 / Ok1$$

$Pk1$ _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

$Vmink1$ _____ Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet

$Pmaxk1$ _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

$Ok1$ _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

b. Përvoja (Eksperiencia) e kuzhinierit 0- 5 pikë

Kuzhinieri përbën shtyllën operative të shërbimit të gatimit, duke qenë përgjegjës për përgatitjen praktike të vakteve, zbatimin e recetave, ruajtjen e higjienës gjatë procesit të gatimit dhe bashkëpunim të ngushtë me kryekuzhinierin.

Përvoja profesionale mbi 2 vite është e rëndësishme për disa arsye teknike, pasi siguron zotërimin praktik të teknikave të gatimit dhe përdorimit të pajisjeve profesionale, ndihmon në standartizimin e recetave/dietave ditore, duke garantuar sasi, cilësi, dhe kalori të përcaktuara nga AK, rrit sasinë dhe efikasitetin në kushte intensive pune pa kompromentuar sigurinë ushqimore, ndikon në reduktimin e mbetjeve të gjeneruara nga ushqimi.

Përvoja mbi 2 vite pune tregon se kuzhinieri zotëron aftësi për punë të pavarur, menaxhim të proceseve të gatimit, bashkëpunimin efektiv me stafin e kuzhinës

Metoda e verifikimit:

Eksperiencia minimale në punë të ngjashme për kuzhinerin është 2 vite, vitë të vlerësuara si periudha minimale e nevojshme për t'u familjarizuar me: ciklet e punës së pajisjeve, kontrollin e temperaturave, procedurat e sigurisë gjatë përdorimit. Këto njohuri teknike nuk fitohen vetëm nëpërmjet formimit teorik, por kërkojnë praktikë reale pune. Nëse kjo eksperiencë është 2 vite ose më pak, oferta nuk merr asnjë pikë.

Me 10 pikë do të vlerësohen ofetuesit të cilët do të dëshmojnë se kanë në stafin e tyre kuzhinier me përvojën më të lartë, sepse përvoja më e lartë në punë tregon rritje profesionale, përmirëson efikasitetin dhe cilësinë e shërbimit, reflekton ekspertizë të konsoliduar dhe përvojë në kushte intensive pune. **Ofertuesit e tjerë vlerësohen sipas formulës në rend zbritës.**

Dokumentet për verifikim:

Për të përmbushur këtë kërkesë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Librezë pune/ deklaratë e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ cv dhe/ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton ekspseriencën në shërbime të ngjashme.

Vlerësimi do të bëhet si më poshtë:

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$Pk1 = Vmink1 \times Pmaxk1 / Ok1$

$Pk1$ _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

$Vmink1$ _____ Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet

$Pmaxk1$ _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

$Ok1$ _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE) Komisioni konstaton se në këtë procedurë prokurimi kanë dorëzuar ofertën ekonomike operatorët ekonomikë, si më poshtë vijon;

1	"4 S" SHPK	50.004.375	leke
2	"DION-AL" SHPK	54.508.410	leke
3	"DRIVE EXPERT ALBANIA" SHPK	56.830.050	leke

III.1.3. Në datë 11.02.2026, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerësoni procedurën e prokurimit, duke bërë vlerësimin e me pikë të ofertave të kualifikuara, si më poshtë vijon:

1	"DION-AL" SHPK	282	pikë	kualifikuar
2	"4 S" SHPK	261	pikë	kualifikuar
3	"DRIVE EXPERT ALBANIA" SHPK	224,55	pikë	kualifikuar

III.1.4. Nisur nga kriterete vlerësimit të përcaktuara në pikën 4.4 "Kriteret e përzgjedhjes së fituesit" të Seksionin 4 "Procedura" të dokumentave të tenderit të modifikuara të procedurës

së prokurimit objekt ankimi, operatorët ekonomikë ofertues të kualifikuar kanë dorëzuar në dokumentacionin e ofertës, dokumentat si më poshtë vijon:

Ofertuesi “4 S” SHPK:

Shtojcën 10 “FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT” të firmosur dhe vulosur nga administratori i shoqërisë “4 S” SHPK, ku në Pjesën III: “Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit”, Seksioni B: “DEKLARATË ‘Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohet)’” ka deklaruar, si më poshtë vijon:

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:</p> <p>Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.</p>	<p><u>Punonjës</u> Po [X] Jo []</p> <p>numri i punonjësve: XX punonjës</p> <hr/> <p><u>Profili i punonjësve:</u> Të ndryshëm – Drejtues ligjor, Punëtor shpërndarës, Teknolog, Brumëgatues, Kryekuzhinier, Kuzhinier, Ndhimëskuzhinier, Kamarier, Sanitare etj.</p> <p><u>Kryekuzhinier: D. D</u></p> <p><u>Kuzhinier: E. S.</u></p> <p>Ndhimëskuzhinier: E. Gj / T. N / S. K</p> <p>Punonjës shpërndarës: Xh. K / M. K / M. R</p> <p>Sanitare: Z. G / S. Di</p> <p>Shofer: R. E / A. D</p> <p><u>Makineri e mjete</u> Po [X] Jo []</p> <p>Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:</p> <p>Automjete – AA XXX IG, AA XXX RV, AA XXX SA, AB XXX DK, AB XXX EU, AB XXX MG, AB XXX TA, AA XXX OB, AA XXX RC</p>
<p>Emri, Mbiemri XH. S Firma _____</p>	

Vula _____

Data e dorëzimit të deklaratës _____

- Kontratë pune datë 25.01.2026, të lidhur midis punëdhënësit “4 S” SHPK dhe punëmarrësit z. D. D, i cili punësohet pranë punëdhënësit në pozicionin “Kryekuzhinier”, për një periudhë kohore deri në datë 31.12.2030.
- Certifikatë Nr. Amzës: XXXXX, datë 22.04.2010, e lëshuar nga Subjekti Privat i Formimit Profesional “VITRINA”, ku vërtetohet se z. D. D ka përfunduar kursin “Kuzhinier”.
- Certifikatë Nr. XXXX, datë 01.10.2025 e vlefshme deri në datë 30.09.2028, e lëshuar nga trupa certifikuese “AQScert”, ku vërtetohet se z. D. D është kualifikuar për “SPECIALIST I SIGURISË USHQTMORE DHE METODAVE H.A.C.C.P”, ku vërtetohet se ka përfituar aftësitë për: “Identifikimi dhe menaxhimi i pikave kritike të kontrollit në sigurinë ushqimore; Hartimi; implementimi; rregjistrimi dhe kontrolli i dokumentacionit HACCP në sektorë të ndryshëm ushqimor; Legjistacioni ushqimor në Shqipëri dhe Analizimi i risqeve të sigurisë ushqimore.”.
- Certifikatë Nr. XXXX, datë 30.01.2026, e lëshuar nga qendra e formimit profesional jopublik “RoyalCert Albania Academy”, ku vërtetohet se z. D. D ka kryer me sukses trajnimin dhe kursin e formimit profesional, ku vërtetohet se ka përfituar aftësitë për: “Siguria ushqimore; Cilësia ushqimore; Teknologjitë ushqimore; Baza ligjore për OBU-t; Kërkesat e HACCP-it; Praktikat e mira të punës; PMP; Praktikat e mira të higjenës dhe PMH.”.
- Vërtetim për bazën e vlerësuar datë 27.01.2026, e lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore për z. D. D, ku vërtetohet se ka derdhur kontributet mujore mbi bazën e pagës bruto për 96 (nëntëdhjet e gjashtë) muaj, në periudhën e punësimit nga muaji shtator 2015 deri në muajin dhjetor 2025.
- Kontratë pune datë 25.01.2026, të lidhur midis punëdhënësit “4 S” SHPK dhe punëmarrësit znj. E. S, e cila punësohet pranë punëdhënësit në pozicionin “Kryekuzhinier”, për një periudhë kohore deri në datë 31.12.2030.
- Certifikatë Nr. Amzës: XXX, datë 29.03.2022, e lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Ofrimit të Formimit Profesional Publik Nr. 1, Tiranë, ku vërtetohet se znj. E. S ka përfunduar me sukses Kursin e Unifikuar “Kuzhinë”, ku vërtetohet se ka përfituar aftësitë për: “Hyrje në profesionin e kuzhinierit; Përgatitja e buljonit dhe supave të thjeshta; Përgatitja e sallatave dhe antipastave; Përgatitja e asortimenteve të thjeshta me mish; Përgatitja e asortimenteve të thjeshta me peshk dhe me fruta deti dhe Përgatitja e brumërave.”.

- *Certifikatë Nr. XXX, datë 26.08.2024, e lëshuar nga qendra e formimit profesional jopublik “RoyalCert Albania Academy”, ku vërtetohet se znj. E. S ka kryer me sukses kursin e formimit profesional, ku vërtetohet se ka përfutuar aftësitë për: “Siguria ushqimore; Teknologjitë ushqimore, Baza ligjore për OBU-t; Kërkesat e HACCP-it; Praktikrat e mira të punës; PMP; Praktikrat e mira të higjenës dhe PMH.”.*
- *Certifikatë Nr. XXX, datë 01.10.2025 e vlefshme deri në datë 30.09.2028, e lëshuar nga trupa certifikuese “AQScert”, ku vërtetohet se znj. E. S është kualifikuar për “SPECIALIST I SIGURISË USHQTMORE DHE METODAVE H.A.C.C.P”, ku vërtetohet se ka përfutuar aftësitë për: “Identifikimi dhe menaxhimi i pikave kritike të kontrollit në sigurinë ushqimore; Hartimi; implementimi; rregjistrimi dhe kontrolli i dokumentacionit HACCP në sektorë të ndryshëm ushqimor; Legjistacioni ushqimor në Shqipëri dhe Analizimi i risqeve të sigurisë ushqimore.”.*
- *Vërtetim për bazën e vlerësuar datë 27.01.2026, e lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore për znj. E. S, ku vërtetohet se ka derdhur kontributet mujore mbi bazën e pagës bruto për 101 (njëqind e një) muaj, në periudhën e punësimit nga muaji shkurt 2016 deri në muajin dhjetor 2025.*

Ofertuesi “DION-AL” SHPK:

Shtojcën 10 “FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT” të firmosur dhe vulosur nga administratori i shoqërisë “DION-AL” SHPK, ku në Pjesën III: “Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit”, Seksioni B: “DEKLARATË ‘Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohet)’” ka deklaruar, si më poshtë vijon:

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
<i>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:</i>	<u>Punonjës</u> Po [X] Jo [] numri i punonjësve: X (X) punonjës për periudhën Dhjetor 2025
<i>Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta</i>	<u>Profili i punonjësve:</u> 1. V. Sh – Kryekuzhinier 2. <u>Ë. P (M) – Kryekuzhinier</u> 3. <u>L. B – Kuzhinier</u> 4. A. G – Ndihmës Kuzhinier 5. F. H – Punonjës shpërndarës 6. S. K - Punonjës shpërndarës 7. V. R – Sanitare 8. L. Xh – Sanitare

<p>paraqes në kopje originale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.</p>	<p>9. I. Ll – Shofer</p> <p><u>Makineri e mjete</u> Po [X] Jo []</p> <p>Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:</p> <p>Mjet transporti frigoriferik me targë – AAXXXOM, me nr. Leje qarkullimi TRXXXX, me nr shasie XXX</p>
<p>Emri, Mbiemri J.Z Firma _____ Vula _____ Data e dorëzimit të deklaratës _____</p>	

- Kontratë pune datë 11.11.2025, të lidhur midis punëdhënësit “DION-AL” SHPK dhe punëmarrësit znj. Ë. P (M), e cila punësohet pranë punëdhënësit në pozicionin “Kryekuzhinier”, për një periudhë kohore “pa afat”..
- Dëshmi kualifikimi nr. Amzës: XXX, lëshuar në datën 16.08.1978, nga shkolla “E Ushqimit Social” ku vërtetohet se znj. Ë. M është kualifikuar në specialitetin “Kuzhinier”, ku vërtetohet se ka përfutuar aftësitë për: “Teknologji; Kalkulim; Higjenë; Merceollogji; Organizim; Planifikim; Paisje; Projektim dhe Praktikë profesioni.”.
- Certifikatë Nr. XXX, datë 13.03.2025 e vlefshme deri në datë 12.03.2028, e lëshuar nga trupa certifikuese “CERT-ERN”, ku vërtetohet se znj. Ë. P ka kryer me sukses trajnimin “Trajnimi ISO 22000 – Food SAFETY Management”, ku vërtetohet se ka përfutuar aftësitë për: “Hyrje në ISO 22000; Struktura e sistemit të menaxhimit të sigurisë ushqimore (FSMS); Zhvillimi i proceseve të sistemit të menaxhimit të sigurisë ushqimore; Programet parakushtuese (FPR); Pastrimi dhe higjena; Kontrrolli i dëmtuesve; Menaxhimi i furnizuesve; Higjena personale; Analiza e riskut dhe plani HACCP dhe Marrëdhënia me Codex HACCP, ISO 9001, FSSC 22000.”.
- Certifikatë Nr. XXX, datë 06.03.2025 e vlefshme deri në datë 05.03.2028, e lëshuar nga trupa certifikuese “CERT-ERN”, ku vërtetohet se znj. Ë. P ka kryer me sukses trajnimin “Trajnimi HACCP (Niveli 2 – 4)”, ku vërtetohet se ka përfutuar aftësitë për: “4 nivele e trajnimit HACCP (kategoritë, kush përfshihet dhe temat për secilin nivel); Niveli 1 - HACCP / Ndërgjegjësim për sigurinë ushqimore; Niveli 2 - Parimet HACCP / Siguria Ushqimore për Përpunuesit; Niveli 3 - HACCP i Ndërmjetëm / Mbikqyrës; Niveli 4 - HACCP i Avancuar / Menaxhere; Projektim i Sistemit HACCP; Zhvillimi i Analizës së Rriskut dhe Kultura e sigurisë ushqimore dhe kërkesat ligjore.”.

- *Certifikatë Nr. XXX, datë 28.03.2025 e vlefshme deri në datë 27.03.2028, e lëshuar nga trupa certifikuese "CERT-ERN", ku vërtetohet se znj. E. P ka kryer me sukses trajnimin "për Higjenën dhe Sigurinë Ushqimore / Food Hygiene & Safety Training", ku vërtetohet se ka përfituar aftësitë për: "Hyrje në Sigurinë Ushqimore; Rreziqet mikrobiologjike të ushqimit; Rreziqet kimike dhe fizike; Menaxhimi i alegjeneve; Kontaminimi dhe Kontaminimi i kryqëzuar; Higjena personale; Kontrrolli i kohës dhe temperaturës; Ruajtja dhe trajtimi i ushqimit; Pastrimi dhe dezinfektimi; Kontrrolli i dëmtuesve; Higjena e pajisjeve dhe objekteve dhe Praktikën e sigurt të përgatitjes së ushqimit."*
- *Jetëshkrim (CV-i) të znj. E. P, ku deklaron eksperiencat në punë, si më poshtë vijon:
"Kryekuzhinier (XXXX; 2016 - e në vazhdim)
Angazhim profesional (Shërbime ushqime kolektive) "XXX sh.p.k; 2013 - 2016"
Kuzhinier (XXX sh.p.k; 2013 - 2016)
Kryekuzhinier (Restorant "XXX" XXX; 1995 - 2011)".*
- *Librezë pune e punëmarrësit znj. E. P lëshuar nga punëdhënësi "XXX" SHPK, ku deklarohet si më poshtë vijon:
"Në datën 01 janar 2013 është punësuar tek shoqëria "XXX" SHPK me detyrën "Kuzhinier" dhe është larguar nga shoqëria "XX" SHPK në datën 01 tetor 2019.
Nga data 18 shkurt 2023 e në vazhdim është punësuar tek shoqëria "XX" SHPK me detyrën "Kuzhinier"."*
- *Vërtetim për bazën e vlerësuar datë 27.01.2026, e lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore për znj. E. P, ku vërtetohet se ka derdhur kontributet mujore mbi bazën e pagës bruto për 132 (njëqind e tridhjet e dy) muaj, në periudhën e punësimit nga muaji janar 2013 deri në muajin dhjetor 2025.*
- *Kontratë pune datë 11.11.2025, të lidhur midis punëdhënësit "DION-AL" SHPK dhe punëmarrësit z. V. Sh, i cili punësohet pranë punëdhënësit në pozicionin "Kryekuzhinier", për një periudhë kohore "pa afat"..*
- *Dëshmi kualifikimi nr. Amzës: XXX, lëshuar në datën 16.08.1979, nga shkolla "E Ushqimit Social" ku vërtetohet se z. V. Sh është kualifikuar në specialitetin "Kuzhinier", ku vërtetohet se ka përfituar aftësitë për: "Teknologji; Kalkulim; Higjenë; Merceollogji; Organizim; Planifikim; Paisje; Projektim dhe Praktikë profesioni."*
- *Certifikatë Nr. XXX, datë 28.03.2025 e vlefshme deri në datë 27.03.2028, e lëshuar nga trupa certifikuese "CERT-ERN", ku vërtetohet se z. V. Sh ka kryer me sukses trajnimin "për Higjenën dhe Sigurinë Ushqimore / Food Hygiene & Safety Training", ku vërtetohet se ka përfituar aftësitë për: "Hyrje në Sigurinë Ushqimore; Rreziqet mikrobiologjike të ushqimit; Rreziqet kimike dhe fizike; Menaxhimi i alegjeneve;*

Kontaminimi dhe Kontaminimi i kryqëzuar; Higjena personale; Kontrrolli i kohës dhe temperaturës; Ruajtja dhe trajtimi i ushqimit; Pastrimi dhe dezinfektimi; Kontrrolli i dëmtuesve; Higjena e pajisjeve dhe objekteve dhe Praktikat e sigurta të përgatitjes së ushqimit.”.

- *Certifikatë Nr. XXX, datë 13.03.2025 e vlefshme deri në datë 12.03.2028, e lëshuar nga trupa certifikuese “CERT-ERN”, ku vërtetohet se z. V. Sh ka kryer me sukses trajnimin “Trajnimi ISO 22000 – Food SAFETY Management”, ku vërtetohet se ka përfituar aftësitë për: “Hyrje në ISO 22000; Struktura e sistemit të menaxhimit të sigurisë ushqimore (FSMS); Zhvillimi i proceseve të sistemit të menaxhimit të sigurisë ushqimore; Programet parakushtuese (FPR); Pastrimi dhe higjena; Kontrrolli i dëmtuesve; Menaxhimi i furnizuesve; Higjena personale; Analiza e riskut dhe plani HACCP dhe Marrëdhënia me Codex HACCP, ISO 9001, FSSC 22000.”.*
- *Jetëshkrim (CV-i) të z. V. Sh, ku deklaron eksperiencat në punë, si më poshtë vijon:
“Kryekuzhinier (XXX; 2025 - e në vazhdim)
Kuzhinier/Kryekuzhinier (XX XX; 2021-2024)
Kuzhinier/Kryekuzhinier (XX XX; 2018-2020)
Kuzhinier/Kryekuzhinier (XXX; 2016-2018)
Kuzhinier/Kryekuzhinier (XX XX; 2015-2016)”.*
- *Vërtetim për bazën e vlerësuar datë 22.01.2026, e lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore për z. V. Sh, ku vërtetohet se ka derdhur kontributet mujore mbi bazën e pagës bruto për 101 (njëqind e një) muaj, në periudhën e punësimit nga muaji janar 2015 deri në muajin dhjetor 2025.*
- *Kontratë pune datë 11.11.2025, të lidhur midis punëdhënësit “DION-AL” SHPK dhe punëmarrësit znj. L. B, i cili punësohet pranë punëdhënësit në pozicionin “Kuzhinier”, për një periudhë kohore “pa afat”.*
- *Certifikatë nr. Amzës: XXX, lëshuar në datën 13.01.2017, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Vlorë” ku vërtetohet se znj. L. B është kualifikuar në specialitetin “Kuzhinier”, ku vërtetohet se ka përfituar aftësitë për: “Njohuri të përgjithshme mbi profesionin e kuzhinierit. Gatimet bazë (Pjata e parë) sallata, salca, supa, kima, tasqebap, brumrat; Gatimi i mishrave; Gatimi i peshkut e prodhimeve të tjera të detit; Gatime në pritje, festa dhe ceremoni të tjera. Organizimi i punës në të tilla raste. Organizimi dhe ngritja e një ekonomie; Kuzhina tradicionale.”.*
- *Certifikatë Nr. CERN/CEHP/22023432425, datë 06.03.2025 e vlefshme deri në datë 05.03.2028, e lëshuar nga trupa certifikuese “CERT-ERN”, ku vërtetohet se znj. L. B ka kryer me sukses trajnimin “Trajnimi HACCP (Niveli 2 – 4)”, ku vërtetohet se ka përfituar aftësitë për: “4 nivele e trajnimit HACCP (kategoritë, kush përfaqësohet dhe*

temat për secilin nivel); Niveli 1 - HACCP / Ndërgjegjësim për sigurinë ushqimore; Niveli 2 - Parimet HACCP / Siguria Ushqimore për Përpunuesit; Niveli 3 - HACCP i Ndërmjetëm / Mbikqyrës; Niveli 4 - HACCP i Avancuar / Menaxhere; Projektim i Sistemit HACCP; Zhvillimi i Analizës së Rrishtit dhe Kultura e sigurisë ushqimore dhe kërkesat ligjore.”.

- *Certifikatë Nr. XXX, datë 13.03.2025 e vlefshme deri në datë 12.03.2028, e lëshuar nga trupa certifikuese “CERT-ERN”, ku vërtetohet se znj. L. B ka kryer me sukses trajnimin “Trajnimi ISO 22000 – Food SAFETY Management”, ku vërtetohet se ka përfutuar aftësitë për: “Hyrje në ISO 22000; Struktura e sistemit të menaxhimit të sigurisë ushqimore (FSMS); Zhvillimi i proceseve të sistemit të menaxhimit të sigurisë ushqimore; Programet parakushtuese (FPR); Pastrimi dhe higjena; Kontrrolli i dëmtuesve; Menaxhimi i furnizuesve; Higjena personale; Analiza e rrishtit dhe plani HACCP dhe Marrëdhënia me Codex HACCP, ISO 9001, FSSC 22000.”.*
- *Librezë pune e punëmarrësit znj. L. B lëshuar nga punëdhënësi “XXX” SHPK, ku deklarohej si më poshtë vijon:
“Në datën 24 shkurt 2017 është punësuar tek shoqëria “XXX” SHPK me detyrën “Kuzhinier” dhe është larguar nga shoqëria “XXX” SHPK në datën 13 korrik 2017.
Në datën 02 shkurt 2019 është punësuar tek shoqëria “XXX” SHPK me detyrën “Kuzhinier” dhe është larguar nga shoqëria “XXX” SHPK në datën 09 tetor 2019.
Në datën 10 tetor 2019 është punësuar tek shoqëria “XXX” SHPK me detyrën “Kuzhinier” dhe është larguar nga shoqëria “XXX” SHPK në datën 10 gusht 2020.
Në datën 08 tetor 2020 është punësuar tek shoqëria “XXX” SHPK me detyrën “Kuzhinier” dhe është larguar nga shoqëria “XXX” SHPK në datën 22 maj 2023.
Nga data 03 dhjetor 2024 e në vazhdim është punësuar tek shoqëria “XXX” SHPK me detyrën “Kuzhinier”.”.*
- *Jetëshkrim (CV-i) të znj. L. B, ku deklarohet eksperiencat në punë, si më poshtë vijon:
“Kryekuzhinier (XXX; 2017 - 2025)
Kuzhinier profesional (XXX; 2023 - 2024)
Kuzhinier (XXX; 2017 - 2019)
Përgatitje vaktesh për numër të madh personash (XXX; 2012-2016)”.*
- *Vërtetim për bazën e vlerësuar datë 29.01.2026, e lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore për znj. L. B, ku vërtetohet se ka derdhur kontributet mujore mbi bazën e pagës bruto për 138 (njëqind e tridhjetë e tetë) muaj, në periudhën e punësimit nga muaji janar 2012 deri në muajin dhjetor 2025.*

Ofertuesi “DRIVE EXPERT ALBANIA” SHPK:

Shtojcën 10 “FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT” të firmosur dhe vulosur nga administratori i shoqërisë “DRIVE EXPERT ALBANIAAL” SHPK, ku në Pjesën III:

“Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit”, Seksioni B: “DEKLARATË ‘Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohet)’” ka deklaruar, si më poshtë vijon:

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:</p> <p>Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.</p>	<p><u>Punonjës</u> Po [X] Jo []</p> <p>Nëse, po, numri i punonjësve: Janar – Dhjetor 2025 (numri mesatar është mbi XX punonjës) Janar 2026 (numri mesatar mbi XXpunonjës)</p> <hr/> <p><u>Profili i punonjësve:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. D. K (K) (Drejtuese teknik – Teknologe Agroushqimore) (Diploma nr. XXX, datë 05.05.2009 Universiteti Bujqësor Tiranë, Kontratë Pune. Librezë Pune, - mbi X vite eksperiencë) 2. S. H, Kryekuzhinier, pajisur me Certifikatë nga ICAP në datë 12.03.2013, me përvojë rreth XX vjeçare. 3. N. M (Kuzhinier) (Certifikatë nr. XXX, datë 09.05.2023 “Kuzhinë”, Kontratë Pune, Librezë Pune, me mbi X vite eksperiencë) 4. F. C, Nd/Kuzhinier (Kontratë Pune, Librezë Pune me mbi X vite eksperiencë) 5. L. U Shpërndarës Ushqimi (Kontratë Pune) 6. S. A Shpërndarës Ushqimi (Kontratë Pune) 7. V. R, Sanitare (Kontratë Pune) 8. V. S, Sanitare (Kontratë Pune) 9. A. Ç, Shofer (Kontratë Pune, Leje Drejtimi “X”) <p><u>Makineri e mjete</u> Po [X] Jo []</p> <p>Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:</p>

	AB XXX TK – Mjet Frigoriferik XXX (Në pronësi) Pajisur me të gjithë dokumntacionin e kërkuar në kriterin e pikës 2.3.4.
Emri, Mbiemri R. T Firma _____ Vula _____ Data e dorëzimit të deklaratës _____	

- Kontratë pune datë 24.09.2025, të lidhur midis punëdhënësit “DRIVE EXPERT ALBANIA” SHPK dhe punëmarrësit z. S. H, i cili punësohet pranë punëdhënësit në pozicionin “Kryekuzhinier”, për një periudhë kohore deri në datën 24.12.2026.
- Certifikatë datë 12.03.2013, e lëshuar nga Instituti Culinary Albania Professional (ICAP), ku vërtetohet se z. S. H ka përfunduar kursin 3 – mujor gjatë periudhës Nëntor 2012 – Shkurt 2013 dhe vlerësohet i denjë për të ushtruar profesionin e “KUZHINIERIT”.
- Vërtetim për bazën e vlerësuar datë 24.01.2026, e lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore për z. S. H, ku vërtetohet se ka derdhur kontributet mujore mbi bazën e pagës bruto për 152 (njëqind e pesëdhjet e dy) muaj, në periudhën e punësimit nga muaji janar 2012 deri në muajin dhjetor 2025.
- Jetëshkrim (CV-i) të z. S. H, ku deklaron eksperiencat në punë, si më poshtë vijon:
“N/kuzhinier (Taverna XXX; Qershor - Shtator 2008)
N/kuzhinier (XXX RESORT; DHJETOR 2009 - DHJETOR 2013)
Kuzhinier (XXX RESORT; Janar 2013 - Korrik 2017)
Kuzhinier (Restorant XXX; Shtator 2017 - Tetor 2018)
Kuzhinier (XXX RESORT; tetor 2018 - nentor 2019)
Kuzhinier (Restorant XXX; nentor 2019 - maj 2020)
Kuzhinier (XXX BUTIK HOTEL; maj 2020 - tetor 2020)
Kuzhinier (XXX XXX RESTAURANT; tetor 2020 - dhjetor 2022)
Kuzhinier (X&X HOTEL; maj 2022 - shtator 2022)
Kuzhinier (XXX; maj 2023 - tetor 2023)”.
- Kontratë pune datë 05.03.2022, të lidhur midis punëdhënësit “DRIVE EXPERT ALBANIA” SHPK dhe punëmarrëses znj. N. M, e cila punësohet pranë punëdhënësit në pozicionin “Kuzhinier”, për një periudhë kohore deri në datën 05.06.2023.
- Certifikatë nr. Amzës: XXX, lëshuar në datën 09.05.2023, nga Drejtoria Rajonale e Ofrimit Profesional Publik Nr. 4, Tiranë ku vërtetohet se znj. N. M është kualifikuar në specialitetin “Kuzhinë”.

- *Librezë pune e punëmarrësit znj. N. M i lëshuar nga punëdhënësi XXX, ku deklarohej si më poshtë vijon:
“Nga data 05 mars 2022 e në vazhdim është punësuar tek shoqëria “XXX” SHPK me detyrën “Kuzhinier”.”.*

III.1.5. Lidhur me pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues “4 S” SHPK autoriteti kontraktor me shkresën nr. 3624/20 prot, datë 05.03.2026 “Mbi shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “4 S” shpk, lidhur me dokumentet e tenderit në procedurën e prokurimit me nr. REF-67408-10-31-2025, me objekt: Loti 1 ‘Gatim dhe shpërndarje ushqimi për Njësinë e Sigurisë Publike Tiranë”” protokolluar me tonën me nr. 601/5 prot, datë 09.03.2026 ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresën nr. 3624/19 prot, datë 05.03.2026 “Vendim K.SHA. 38/2026”, ku e ka shqyrtuar këto pretendime të ankimuesit si në vijim: “Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave në vijim të shqyrtimit konstaton se për kriterin e parë, **Kualifikimi dhe përvoja e Kryekuzhinierit:** [0-15]

pikë, e ndarë:

a. Kualifikimi profesional: 0- 5 pikë

...

Nga procesverballi i vlerësimit të ofertave të paraqitura, mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave rezultoi se:

Për plotësimin e kriterit OE “4 S” shpk ka paraqitur dokumentacion për Kryekuzhinierin e deklaruar.

- *Z. D. D. ka paraqitur Kontratë Individuale të punës, si dhe certifikatat/dëshmitë si më poshtë.*

- 1. Certifikatë kursi “Kuzhinë”, datë 21.04 2024 Subjekti i Formimit Profesional VITRINA.*
- 2. Certifikatë kualifikimi për “Specialist i Sigurisë Ushqimore dhe Metodikave H A C C. P”,*
- 3. Certifikatë trajnimi “Siguria Ushqimore, Cilësia Ushqimore, Teloilogjitetë Ushqimore, Baza Ligjore për OBU-t, Kërkesat e HACCP-it, Praktikat e mira të punës PMP, Praktikat e mira të higjienës / PMH”.*
- 4. Vërtetim i Bazës së Vlerësuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dt. 27.01.2026.*

Për sa më sipër, llogaritja e pikëve për këtë kriter është realizuar në varësi të numrit të certifikatave dhe respektivisht kualifikimeve që ato përmbajnë, të paraqitura nga Operatori ekonomik ankimues “4 S” sh.p.k. Lidhur me pretendimin konkret të këtij të fundit se dokumenti “Certifikatë Trajnimi”, i cili përmban disa module si: “Siguria Ushqimore, Cilësia Ushqimore, Teknologjitetë Ushqimore, Baza Ligjore për OBU-të, Kërkesat e HACCP-it, Praktikat e Mira të Punës (PMP), Praktikat e Mira të Higjienës (PMH)”, duhet të trajtohet dhe rrjedhimisht, të llogaritet si më shumë se një dokument (pra si disa dokumente/certifikata të veçanta), ky pretendim nuk qëndron.

Së pari, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur rezultoi se dokumenti konkret është lëshuar si një certifikatë e vetme, me një numër unik identifikimi, me një datë të vetme lëshimi dhe nga një subjekt i vetëm certifikues. Ai nuk përmban ndarje formale në disa certifikata të pavarura, por përfaqëson një trajnim të integruar, i strukturuar në disa module përbërëse.

Në këtë kuptim, modulet përbëjnë pjesë përmbajtësore të një programi të vetëm trajnimi dhe jo kualifikime të pavarura, të certifikuara secila me dokument më vete.

Së dyti, qëllimi i kriterit të vlerësimit ka qenë evidentimi i numrit të certifikatave apo kualifikimeve të provuara përmes dokumenteve të veçanta, të cilat dëshmojnë ndjekjen dhe përfundimin e trajnimeve të ndryshme. Në rastin konkret, ndonëse përmbajtja e certifikatës përfshin disa fusha tematike, kjo e fundit materializohet në një akt të vetëm administrativ, i cili nuk fragmentohet artificialisht për qëllime pikëzimi. Çdo interpretim i kundërt do të çonte në një deformim të barazisë në vlerësim, pasi do të lejonte shumëfishimin e pikëve mbi bazën e një dokumenti të vetëm formal.

Së treti, pranimi i këtij pretendimi do të krijonte një precedent të papërshtatshëm dhe në kundërshtim me parimet e trajtimit të barabartë dhe proporcionalitetit, duke favorizuar operator ekonomik që paraqesin certifikata me përmbajtje të strukturuar në disa module, krahasuar me ata që paraqesin certifikata të ndara për secilin trajnim. Në thelb, vlerësimi duhet të mbështetet mbi dokumente të veçanta dhe të pavarura, jo mbi ndarjen e brendshme tematike të një dokumenti të vetëm..

Së katërti, vetë natyra e një certifikate trajnimi me disa module nënkupton një program të unifikuar formimi profesional, ku modulet janë elementë përbërës të një kurrikule të vetme dhe jo trajnime të certifikuara në mënyrë të pavarur. Në mungesë të dokumenteve të ndara, të cilat të provojnë qartësisht certifikime të ndryshme, autoriteti vlerësues nuk mund dhe nuk duhet të bëjë një ndajë të tillë artificiale.

Për rrjedhojë, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka vepruar drejt dhe në përputhje me dokumentacionin e paraqitur, duke e konsideruar dokumentin “Certifikatë Trajnimi” si një dokument të vetëm dhe duke e pikëzuar si të tillë.

Pretendimi i Operatorit ekonomik “4 S” sh.p.k. për shumëfishimin e pikëve mbi bazën e ndarjes së moduleve të një certifikate të vetme dhe konsiderimin e tyre si një numër total prej 9 kualifikimesh, rezulton i pabazuar dhe i pa argumentuar në fakte konkrete provuese.

b. Përvoja (Eksperienca) e kryekuzhinierit:

0 - 10 pikë

...

Nga procesverbali i vlerësimit të ofertave të paraqitura, mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave rezulton se:

➤ *Për plotësimin e kriterit OE “4 S” shpk ka paraqitur dokumentacion për Kryekuzhinierin e deklaruar, Z. D, D., më poshtë*

1. *Deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale (Vërtetim për bazën e vlerësuar).*

Referuar dokumentit të mësipërm, rezulton se në total punonjësi i deklaruar ka një eksperiencë prej 84 muajsh, duke e plotësuar kriterin minimal prej 5 (pesë) vitesh për të marrë pjesë në pikëzimin. (Sqarojmë se eksperiencë prej 84 muaj pune si kryekuzhinier është llogaritur referuar dokumentit Vërtetim i Bazës së Vlerësuar të dorëzuar nga ofertuesi ku i jemi referuar subjekteve të cilat kanë në aktivitet Kuzhinë, Bar Restorant Hotel etj dhe përmbajnë profesionin e kuzhinierit. Nuk janë llogaritur

si eksperinecë muajt në listëpagesë ku personi i deklaruar si Kryekuzhinier ka punuar në subjekte të cilat nuk kanë në aktivitet Kuzhinë, Bar Restorant Hotel etj dhe nuk përmbajnë profesionin e kuzhinierit).

Për sa më sipër, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur lidhur me përvojën e stafit të kërkuar, kryekuzhinier, rezulton se nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave është realizuar një vlerësim dhe përllogaritje e saktë e pikëve respektive lidhur me këtë kriter përzgjedhjeje.

Referuar dokumentit “Vërtetim për Bazën e Vlerësuar”, të paraqitur nga Operatori ekonomik ankimes “4 S”, rezulton se punonjësi i deklaruar në pozicionin e kryekuzhinierit ka një eksperiencë totale prej 84 (tetëdhjetë e katër) muajsh pune, duke përmbushur kriterin minimal prej 5 (pesë) vitesh eksperiencë të kërkuar për efekt të pikëzimit. Në përllogaritjen e kësaj eksperience, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i është referuar në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe ekskluzive dokumentit zyrtar “Vërtetim i Bazës së Vlerësuar”, i cili pasqyron periudhat e sigurimit, subjektet punëdhënëse dhe natyrën e aktivitetit të tyre. Konkretisht, janë konsideruar vetëm ato periudha punësimi në subjekte që kanë në objekt veprimtarie aktivitete të tilla si Kuzhinë, Bar, Restorant, Hotel, apo struktura të ngjashme të shërbimit ushqimor, dhe që përfshijnë profesionin e kuzhinierit.

Nga ana tjetër, nuk janë përfshirë në përllogaritje muajt e punësimit të rezultuar në listëpagesa pranë subjekteve të cilat nuk kanë në aktivitetin e tyre ushtrim të veprimtarisë së kuzhinës apo shërbimeve të hoteleri-turizmit, si dhe nuk përmbajnë në strukturën e tyre profesionale pozicionin e kuzhinierit në referencë me periudhën kohore të stafit në shqyrtim, konkretisht kryekuzhinierit me inicialet D.D. Kjo për arsye se eksperiencë e kërkuar nga dokumentet e procedurës lidhet drejtpërdrejt me ushtrimin efektiv të profesionit të kryekuzhinierit në fusha përkatëse dhe jo thjesht me ekzistencën e një marrëdhënieje pune të përgjithshme. Konkretisht është përjashtuar nga llogaritja periudha kohore e punësimit pranë subjekteve të cilat referuar Ekstraktit Kombëtar të Regjistrimit kanë objekt të ndryshëm të ushtrimit të aktivitetit, konkretisht si tregti me pakicë fruta- perime, bar kafe, etj.

Në këtë kuptim, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka zbatuar një standard vlerësimi material dhe jo format, duke analizuar jo vetëm ekzistencën e kontributeve të paguara, por edhe përputhshmërinë e aktivitetit të subjektit punëdhënës me natyrën e profesionit të kërkuar. Një interpretim i ndryshëm, që do të përfshinte çdo periudhë sigurimi pavarësisht natyrës së aktivitetit, do të binte ndesh me qëllimin e kriterit, i cili synon garantimin e përvojës reale dhe funksionale në fushën specifike të shërbimit të kuzhinës.

Për rrjedhojë, përllogaritja prej 84 muajsh eksperiencë është realizuar mbi baza objektive, të verifikueshme dhe në përputhje me dokumentacionin e paraqitur. Kjo eksperiencë tejkalon pragun minimal prej 60 muajsh (5 vitesh) të kërkuar për kualifikim në pikëzim.

Për sa më sipër, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur lidhur me përvojën e stafit të kërkuar, kryekuzhinierin, konstaton se nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave është realizuar një vlerësim i drejtë, i arsyetuar dhe një përllogaritje e saktë e pikëve respektive lidhur me këtë kriter përzgjedhjeje. Në këto kushte,

nuk konstatohet asnjë element i gabuar në metodologjinë e ndjekur apo në rezultatin e arritur për këtë kriter.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave në vijim të shqyrtimit konstaton se për kriterin e dytë,

Kualifikimi dhe përvoja e Kuzhinierit: [0 - 10] pikë, e ndarë:

c. Kualifikimi profesional: 0 - 5 pikë

...

Nga procesverbali i vlerësimit të ofertave të paraqitura, mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave rezulton se:

- *Për plotësimin e kriterit OE “4 S” shpk ka paraqitur dokumentacion për Kuzhinierin e deklaruar:*
 - *Znj. E. S. ka paraqitur Kontratë Individuale të punës, si dhe certifikatat/dëshmitë si më poshtë:*
 1. *Certifikatë e Kursit të Unifikuar “Kuzhinë”, datë 29.03.2022, Drejtoria e Formimit Profesional Publik.(AKPA)*
 2. *Certifikatë trajnimi “Siguria Ushqimore, Cilësia Ushqimore, Teknologjitë Ushqimore, Baza Ligjore për OBU-t, Kërkesat e HACCP-it, Praktikat e mira të punës / PMP, Praktikat e mira të higjienës / PMH”,*
 3. *Certifikatë kualifikimi për “Specialist i Sigurisë Ushqimore dhe Metodikave H.A.C.C.P”.*
 4. *Vërtetim i bazes së Vlerësuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore 27.01.2026*

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, në përsëritje në argumentimit të sipërcituar, lidhur me kualifikimet e kryekuzhinierit, për analogji thekson të njëjtën vijë logjike edhe për kualifikimet konkrete të kuzhinierit. Referuar dokumentit certifikatë, e cila përmban disa module të pretenduara nga operatori ekonomik ankimues si disa kualifikime/certifikime, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave rithekson se programi konkret është konceptuar si një trajnim i integruar, ku temat si siguria ushqimore, kërkesat e HACCP-it, praktikat e mira të punës dhe të higjienës, baza ligjore dhe elementë të tjerë teknikë, nuk janë kualifikime të ndara, por konsiderohen si pjesë përbërëse të një strukture të vetme formimi profesional. Në përfundim të këtij programi është lëshuar një certifikatë e vetme, me një titull të vetëm dhe me një rezultat përfundimtar të unifikuar.

Nëse një dokument i vetëm do të konsiderohej si disa kualifikime për shkak të moduleve të tij të brendshme, atëherë çdo trajnim i strukturuar me disa kapituj apo tema do të mund të shumëzohet në mënyrë artificiale, duke deformuar logjikën e vlerësimit. Për më tepër, KSHA thekson edhe faktin se nga shqyrtimi i procesit të pikëzimit dhe përlllogaritjeve të kryera nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, është zbatuar i njëjti standard për të gjithë Operatorët ekonomikë ofertues, duke e konsideruar në çdo rast një dokument/certifikatë me disa nëndarje, module, kapituj, si një dokument të vetëm.

Përvoja (Eksperienca) e kuzhinierit

0 - 5 pikë

...

Nga procesverbali i vlerësimit të ofertave të paraqitura, mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave rezulton se:

- *Për plotësimin e kriterit OE “4 S” shpk ka paraqitur dokumentacion për Kuzhinierin e deklaruar, Znj. E.S., si më poshtë:*
- 1. *Deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale (Vërtetim për bazën e vlerësuar).*
Refermar dokumentit të mësipërm, rezulton se në total punonjësi i deklaruar ka një eksperiencë prej 26 muajsh, duke e plotësuar kriterin minimal prej 2 (dy) vitesh për të marrë pjesë në pikëzím. (Sqarojmë se: Eksperiencia prej 26 muaj është llogaritur refermar.
 - a) *Periudhën nga momenti kur i lind e drejta të punojë në profesion Kuzhine datë 23.02.2026 (data e kompletimit të kursit Kuzhinë).*
 - b) *Eksperiencën e plotë pranë subjektit 4 S sh.p.k i cili ka aktivitet bar- restorant ushqim të gatuar të licensuar*

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pasi mori në shqyrtim dokumentacionin e plotë e paraqitur për stafin e kërkuar, konkretisht kuzhinier, lidhur me përvojën/eksperiencën e tij konkludon se punonjësja e deklaruar nga ankimuesi disponon një eksperiencë pune prej 26 muajsh në total, duke plotësuar kështu kriterin minimal prej 2 (dy) vitesh eksperiencë, të kërkuar për qëllime pikëzimi.

KSHA konstaton se për analogji me kryekuzhinierin edhe për kuzhinierin është përdorur e njëjta metodologji pikëzimi, si rezultat i një verifikimi të saktë faktik, si dhe një interpretimi korrekt të kriterit, konkretisht aplikim të drejtpërdrejtë të kërkesës minimale mbi të dhënat e provuara dhe të dokumentuara.

Për sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.”, duke mos pranuar pretendimet e ankumuesit dhe për më tepër duke mos sqaruar pretendimet e ankumuesit për vlerësimin me pikë të ofertave të operatorëve ekonomikë të kualifikuar “DION-AL” SHPK dhe “DRIVE EXPERT ALBANIA” SHPK.

III.1.6. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “4 S” SHPK të parashtruara në pikën III.1., të këtij vendimi, autoriteti kontraktor me shkresën nr. 3624/22 prot, datë 06.03.2026 me objekt “Dërgim dokumentacioni” protokolluar me tonën me nr. 601/7 prot, datë 13.03.2026, ka depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, procesverbalin e vlerësimit të ofertave të mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në datë 11.02.2026, lidhur me vlerësimin eme pikë të ofertave të mësipërme të kualifikuara, nga ku konstatohet si më poshtë vijon :

[...] ... **SHQYRTIMI MBI KUALIFIKIMIN E SUBJEKTEVE SIPAS KËRKESAVE TË PËRGJITHSHME DHE TË VEÇANTA, SHTOJCA 9 E DST**

Nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatorët ekonomikë ofertues për procedurën me objekt : “Loti 1: “Gatim dhe shpërndarje ushqimi për Njësinë e Sigurisë Publike, Tiranë”, rezultoi se:

OE “4 S” shpk

Kualifikohet

Operatori ekonomik “4 S” shpk me NUIS L64425401K, referuar dokumentacionit ligjor dhe teknik të paraqitur në tender, përmbush kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim të përcaktuara në DT. Konkretisht ky subjekt disponon licensën (Catering) dhe në Bashkinë Tiranë, disponon stabilimentin e licensuar brenda bashkisë ku do të zbatohet marrëveshja kuadër, disponon kapacitete financiare të kërkuara ka dorëzuar dokumentet për xhirot vjetore të realizuar, ka paraqitur pasqyrat financiare dhe raportet e auditit financiar, ka realizuar kontratat e ngjashme në masën mbi 39% të FL, disponon stafin sipas profileve të kërkuara për realizimin e kontratës, disponon Certifikaten ISO 22000 “Sistemet e menaxhimit të sigurisë ushqimore”, ka dorëzuar Formularin e Vetdeklarimit sipas Shtojcës 9 të DT, si dhe ka paraqitur sigurimin e ofertës dhe deklaratat e veçanta të kërkuara në përputhje me kërkesat për kualifikim të përcaktuara në DST.

OE “DION-AL” shpk

Kualifikohet

Operatori ekonomik “DION-AL” shpk me NUIS K67917301 H, referuar dokumentacionit ligjor dhe teknik të paraqitur në tender, përmbush kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim të përcaktuara në DT. Konkretisht ky subjekt disponon licensën (katering) dhe në Bashkinë Tiranë, disponon stabilimentin e licensuar brenda bashkisë ku do të zbatohet marrëveshja kuadër, disponon kapacitete financiare të kërkuara ka dorëzuar dokumentet për xhirot vjetore të realizuar, ka paraqitur pasqyrat financiare dhe raportet e auditit financiar, ka realizuar kontratat e ngjashme në masën mbi 39% të FL, disponon stafin sipas profileve të kërkuara për realizimin e kontratës, disponon Certifikatën ISO 22000 “Sistemet e menaxhimit të sigurisë ushqimore”, ka dorëzuar Formularin e Vetdeklarimit sipas Shtojcës 9 të DT, si dhe ka paraqitur sigurimin e ofertës dhe deklaratat e veçanta të kërkuara në përputhje me kërkesat për kualifikim të përcaktuara në DST.

OE “DRIVE EXPERT ALBANIA” shpk

Kualifikohet

Operatori ekonomik “DRIVE EXPERT ALBANIA” shpk me NUIS L72017021 O, referuar dokumentacionit ligjor dhe teknik të paraqitur në tender, përmbush kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim të përcaktuara në DT. Konkretisht ky subjekt disponon licensën (katering) dhe në Bashkinë Tiranë, disponon stabilimentin e licensuar brenda bashkisë ku do të zbatohet marrëveshja kuadër, disponon kapacitete financiare të kërkuara ka dorëzuar dokumentet për xhirot vjetore të realizuar, ka paraqitur pasqyrat financiare dhe raportet e auditit financiar, ka realizuar kontratat e ngjashme në masën mbi 39% të FL, disponon stafin sipas profileve të kërkuara për realizimin e kontratës, disponon Certifikaten “Sistemet e menaxhimit të sigurisë ushqimore”, ka dorëzuar Formularin e Shtojcës 9 të DT, si dhe ka

paraqitur sigurimin e ofertës dhe deklaratat e veçanta të kërkuara në përputhje me kërkesat për kualifikim të përcaktuara në DST.

Në vijim, pas shqyrtimit të dokumentacionit ligjor, ekonomik, teknik dhe përmbushjes së kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave lidhur me ofertat e paraqitura,

V E N D O S I :

• Të kualifikojë operatorët ekonomikë “4 S” shpk me NUIS L64425401K, “DION-AL” shpk me NUIS K67917301H dhe “DRIVE EXPERT ALBANIA” shpk me NUIS L72017021O, për shkak se me dokumentacionin e paraqitur vërtetojnë se plotësojnë të gjitha kërkesat për kualifikim të përcaktuara në DT,

Në vijim, në zbatim të pikës 3, të nenit 82, të kreut X, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, KVO bëri kontrollin aritmetik të ofertave ekonomike të kualifikuara nga ku rezultoi se ofertat e paraqitura nuk kishin gabime aritmetike.

Në vijim, në zbatim të pikës 4, të nenit 82, të kreut X, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar Komisioni verifikoi sipas formulës së përcaktuar në dokumentet e tenderit nëse rezultoni oferta anomalisht të ulëta. Nga kontrolli rezultoi se ofertat nuk janë anomalisht e ulët.

Bazuar në sa më sipër, si dhe në zbatim të nenit 92 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe të nenit 82, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në përfundim të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave për procedurën e prokurimit Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, vendosi të bëjë klasifikimin e ofertave të kualifikuara sipas çmimit, përkatësisht si më poshtë:

Renditja	Operatori Ekonomik	NUIS	Vlera e ofertave (Lekë pa TVSH)
1	“4 S” shpk	L64425401K	50,004,375
2	“DION-AL” shpk	K67917301H	54,508,410
3	“DRIVE EXPERT ALBANIA” shpk	L72017021O	56,830,050

Pas kualifikimit të operatorëve ekonomikë si më lart, KVO vijoi me vlerësimin e dokumentacionit për pikëzimin e ofertës, sipas formulës së përcaktuar në DST duke qenë se kriteri i vlerësimit është përcaktuar Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto më poshtë:

Shpërndarja e pikëve, për çdo Lot si më poshtë:

Kriteri:

1. Çmimi 75
2. **Kuafikimi dhe përvoja e stafit (Kryekuzhinier dhe kuzhinier) [0- 25]**

Vlerësimi i kriterit

1. Çmimi 75 pikë

(4 S) - Pk 1 = $50,004,375 \times 75 / 50,004,375 = 75$

(DION-AL) - Pk 2 = $50,004,375 \times 75 / 54,508,410 = 68.80$

(DRIVE EXPERT ALBANIA) - Pk3 = $50,004,375 \times 75 / 56,830,050 = 65.99$

2. **Kuafikimi dhe përvoja e stafit (Kryekuzhinier dhe kuzhinier) [0- 25] pikë,**

- 2.1 **Kuafikimi dhe përvoja e Kryekuzhinierit: [0- 15] pikë, e ndarë:**

- a. **Kualifikimi profesional: 0- 5 pikë**

Kriteri vlerësohet në mënyrë proporcionale në bazë të numrit të kualifikimeve të dokumentuara, pavarësisht objektit të tyre të detajuar, me kusht që të jenë të lidhura me profesionin e kryekuzhinierit dhe fushat ndihmëse (ushqim, higjienë, siguri ushqimore, menaxhim kuzhine, planifikim menuje, etj.).

Metoda e verifikimit: Komisioni i vlerësimit do të mbështetet në dokumentet e dorëzuara nga operatori ekonomik. Pikët do të jepen në mënyrë proporcionale sipas numrit të kualifikimeve të vlefshme të konstatuara.

Dokumentet për verifikim:

Certifikata profesionale/trajnime që lidhen me zbatimin e standarteve kombëtare e ndërkombëtare, higjienën dhe sigurinë ushqimore, teknika praktike gatimi, menaxhim kuzhine, teknologjia ushqimore dhe inovacionet në gatim, ndërgjegjësime për mjedisin dhe qëndrueshmërinë, etj., apo cdo dokument tjetër që provon kualifikime/trajnime në fusha që lidhen me profesionin e kryekuzhinierit dhe objektin e prokurimit, të lëshuara nga organe të akredituara/të njohura kombëtare apo ndërkombëtarisht.

Për plotësimin e kriterit OE “4 S” shpk ka paraqitur dokumentacion për Kryekuzhinierin e deklaruar:

• Z. D. D. ka paraqitur Kontratë Individuale të punës, si dhe certifikatat/dëshmitë si më poshtë:

1. Certifikatë kursi “Kuzhinë”, datë 21.04.2024 Subjekti i Formimit Profesional VITRINA
2. Certifikatë kualifikimi për “Specialist i Sigurisë Ushqimore dhe Metodikave H.A.C.C.P”,
3. Certifikatë trajnimi “Siguria Ushqimore, Cilësia Ushqimore, Teknologjitë Ushqimore, Baza Ligjore për OBU-t, Kërkesat e HACCP-it, Praktikat e mira të punës / PMP, Praktikat e mira të higjienës /PMH”.

4. Vërtetim i Bazës së Vlerësuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dt. 27.01.2026.

Për plotësimin e kriterit OE “DION-AL” shpk ka paraqitur dokumentacion për Kryekuzhinierin e deklaruar:

1. Dëshmi Kualifikimi “Kuzhinier Kategoria 1”, Diplomë e Shkollës Shtetërore të Mësme Dega Kuzhinë Nr. i Amzës XXX datë 16.08.1978
2. Certifikatë Trajnimi “Trajnim ISO 22000 - Food Safety Management”,
3. Certifikatë Trajnimi “Trajnim HACCP (Niveli 2-4)”,
4. Certifikatë trajnimi “Trajnim për Higjienën dhe Sigurinë Ushqimore”.
5. Vërtetim i Bazës së Vlerësuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dt. 29.01.2026

Për plotësimin e kriterit OE “DRIVE EXPERT ALBANIA” shpk ka paraqitur dokumentacion për Kryekuzhinierin e deklaruar:

Z. S. H. ka paraqitur Kontratë Individuale të punës, si dhe certifikatat/dëshmitë si më poshtë:

1. Certifikatë kursi për të ushtruar profesionin e “Kuzhinierit”. Lëshuar nga ICAP datë 12.03.2013.
2. Vërtetim i Bazës së Vlerësuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dt. 24.01.2026.

Referuar dokumentacionit të paraqitur nga secili operator ekonomik listuar si më sipër, KVO vijoi me pikëzimin për secilin operator, sipas parashikimeve të shkronjës b), pika 8 e nenit 45 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, të ndryshuar, konkretisht:

$P_{k1} = O_{k1} \times P_{maxk1} / V_{maxk1}$

V_{maxk1} ____ vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet;

P_{maxk1} ____ pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet;

O_{k1} ____ treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

1. OE “DION-AL” shpk ka paraqitur 4 (katër) dokumente të kualifikimit profesional për kryekuzhinierin dhe në këto kusht vlerësohet me pikët maksimale, 5 (pesë) pikë.
2. OE “4 S” shpk ka paraqitur 3 (tre) dokumente të kualifikimit profesional për kryekuzhinierin dhe bazuar në formulën e aplikueshme vlerësohet me 3.75 (tre pikë shtatëdhjetë e pesë) pikë.
3. OE “DRIVE EXPERT ALBANIA” shpk ka paraqitur 1 (një) dokument të kualifikimit profesional për kryekuzhinierin dhe bazuar në formulën e aplikueshme vlerësohet me 1.25 (një pikë njëzet e pesë) pikë.

b. Përvoja (Eksperienca) e kryekuzhinierit 0 - 10 pikë

Përvoja profesionale e kryekuzhinierit është një tregues thelbësor i aftësisë për të garantuar cilësinë dhe sigurinë ushqimore gjatë zbatimit të kontratës. Roli i kryekuzhinierit nuk kufizohet vetëm në gatim, por përfshin organizimin e procesit të gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit, menaxhimin e stafit të kuzhinës, hartimin dhe zbatimin e menuve ditore në

përputhje me kërkesat dhe normat e përcaktuara nga AK, zbatimin e sistemit HACCP dhe standarteve të higjienës ushqimore, planifikimin e furnizimeve dhe mbikëqyrjen e sasisë dhe cilësisë së produkteve ushqimore.

Përvoja mbi 5 vite tregon që individi ka kaluar gjithë ciklin profesional të një zhvillimit të njëkuzhinieri drejt nivelit të kryekuzhinierit, duke zotëruar aftësitë në menaxhimin operacional dhe koordinim, eksperiencë në përballimin e volumit të madh të gatimit të racioneve, njohur të konoliduara mbi standartet higjenike dhe të sigurisë. Në shërbime me natyrë të vazhdueshme dhe të ndjeshme si gatimi për institucione të sigurisë publike, përvoja e gatitë kontribuon drejtëpërdrejtë në stabilitetin dhe cilësinë e shërbimit, reduktimin e gabimeve në procesin e përgatitjes dhe shpërndarjes, menaxhimin efektiv të situatave të emergjencës.

Cilësia e ushqimit dhe respektimi i standarteve të sigurisë ushqimore varen nga ekspertiza praktike dhe menaxheriale e kryekuzhinierit.

Metoda e verifikimit:

Ekspierenca minimale në punë të ngjashme për kryekuzhinierin është 5 vite, vite të vlerësuara si përvojë minimale e domosdoshme për të garantuara menaxhimin bazë të kuzhinës. Një eksperiencë e tillë siguron stabilitet dhe njohuri mbi proceset e gatimit. Nëse kjo eksperiencë është 5 vite ose më pak, oferta nuk merr asnjë pikë.

Me 10 pikë do të vlerësohen ofertuesit të cilët do të dëshmojnë se kanë në stafin e tyre kryekuzhinier me përvojën më të lartë, sepse përvoja më e lartë në punë tregon rritje profesionale, ekspertizë të konsoliduar dhe aftësi në optimizimin e proceseve të punës.

Ofertuesit e tjerë vlerësohen sipas formulës në rend zbritës.

Dokumentet për verifikim:

Për të përmbushur këtë kërkesë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Librezë pune/ deklaratat e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ cv dhe/ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton eksperiencën në shërbime të ngjashme.

Për plotësimin e kriterit OE “4 S” shpk ka paraqitur dokumentacion për Kryekuzhinierin e deklaruar, Z. D. D., më poshtë:

1. Deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale (Vërtetim për bazën e vlerësuar).

Referuar dokumentit të mësipërm, rezulton se në total punonjësi i deklaruar ka një eksperiencë prej 84 muajsh, duke e plotësuar kriterin minimal prej 5 (pesë) vitesh për të marrë pjesë në pikëzimin. {Sqarojmë se eksperiencia prej 84 muaj pune si kryekuzhinier është llogaritur referuar dokumentit Vërtetim i Bazës së Vlerësuar të dorëzuar nga ofertuesi ku i jemi referuar subjekteve të cilat kanë në aktivitet Kuzhinë, Bar Restorant Hotel, etj dhe përmbajnë profesionin e kuzhinierit. Nuk janë llogaritur si eksperiencë muajt në listëpagesë ku personi i deklaruar si Kryekuzhinier ka punuar në subjekte të cilat nuk kanë në aktivitet Kuzhinë, Bar Restorant Hotel etj dhe nuk përmbajnë profesionin e kuzhinierit).

Për plotësimin e kriterit OE "DION-AL" shpk ka paraqitur dokumentacion për Kryekuzhinierin e deklaruar, Znj. E. M. (P), më poshtë:

- 1. CV (ku rezultojnë periudhat gjatë të cilave Znj. E. M. (P.) ka punuar si KryeKuzhinierë);*
- 2. Librezë pune;*
- 3. Deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale (Vërtetim për bazën e vlerësuar).*

Referuar dokumentit të mësipërm, rezulton se në total punonjësi i deklaruar ka një eksperiencë prej 348 muajsh, duke e plotësuar kriterin minimal prej 5 (pesë) vitesh për të marrë pjesë në pikëzim.

Për plotësimin e kriterit OE "DRIVE EXPERT ALBANIA" shpk ka paraqitur dokumentacion për Kryekuzhinierin e deklaruar, Z. S. H., si më poshtë:

- 1. Librezë pune;*
- 2. Deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale (Vërtetim për bazën e vlerësuar).*

Referuar dokumentit të mësipërin, rezulton se në total punonjësi i deklaruar ka një eksperiencë prej 156 muajsh, duke e plotësuar kriterin minimal prej 5 (pesë) vitesh për të marrë pjesë në pikëzim.

Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga secili operator ekonomik listuar si më sipër, KVO vijoi me pikëzimin për secilin operator, sipas parashikimeve të shkronjës b), pika 8 e nenit 45 "Kriteret për shpalljen e ofertës fituese", të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, të ndryshuar, konkretisht:

$$Pk1 = Ok1 \times Pmaxk1 / Vmax k1$$

Vmaxk1 ____ vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet;

Pmaxk1 ____ pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet;

Ok1 ____ treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

- 1. Kryekuzhinieri i deklaruar nga OE "DION-AL" shpk ka në total 348 muaj eksperiencë dhe në këto kusht vlerësohet me pikët maksimale, 10 (dhjetë) pikë.*
- 2. Kryekuzhinieri i deklaruar nga OE "DRIVE EXPERT ALBANIA" shpk ka në total 156 muaj eksperiencë dhe bazuar në formulën e aplikueshme vlerësohet me 4.48 (katër pikë dyzet e tetë) pikë.*
- 3. Kryekuzhinieri i deklaruar nga OE "4 S" shpk ka në total 84 muaj eksperiencë dhe bazuar në formulën e aplikueshme vlerësohet me 2.41 (dy pikë dyzet e një) pikë.*

2.2 Kuafikimi dhe përvoja e Kuzhinierit:

[0 - 10] pikë, e ndarë:

a. Kualifikimi profesional:

0 - 5 pikë

Kriteri vlerësohet në mënyrë proporcionale në bazë të numrit të kualifikimeve të dokumentuara, pavarësisht objektit të tyre të detajuar, me kusht që të jenë të lidhura me profesionin e kuzhinierit dhe fushat ndihmëse (ushqim, higjienë, siguri ushqimore, menaxhim kuzhine, etj.).

Metoda e verifikimit: *Komisioni i vlerësimit do të mbështetet në dokumentet e dorëzuara nga operatori ekonomik. Pikët do të jepen në mënyrë proporcionale sipas numrit të kualifikimeve të vlefshme të konstatuara.*

Dokumentet për verifikim:

Certifikata profesionale/trajtime që lidhen me gatimin profesiona, zbatimin e standarteve kombëtare e ndërkombëtare, higjienën dhe sigurinë ushqimore, teknika praktike gatimi, teknologjia ushqimore dhe inovacionet në gatim, ndërgjegjësime për mjedisin dhe qëndrueshmërinë, etj., apo cdo dokument tjetër që provon kualifikime/trajtime në fusha që lidhen me profesionin e kryekuzhinierit dhe objektin e prokurimit, të lëshuara nga organe të akredituara/të njohura kombëtare apo ndërkombëtarisht.

Për plotësimin e kriterit OE “4 S” shpk ka paraqitur dokumentacion për Kuzhinierin e deklaruar:

- *Znj. E. S. ka paraqitur Kontratë Individuale të punës, si dhe certifikatat/dëshmitë si më poshtë:*
 1. *Certifikatë e Kursit të Unifikuar “Kuzhinë”, datë 29.03.2022, Drejtoria e Formimit Profesional Publik.(AKPA)*
 2. *Certifikatë trajnimi “Siguria Ushqimore, Cilësia Ushqimore, Teknologjitë Ushqimore, Baza Ligjore për OBU-t, Kërkesat e HACCP-it, Praktikë e mira të punës / PMP, Praktikë e mira të higjienës / PMH”,*
 3. *Certifikatë kualifikimi për “Specialist I Sigurisë Ushqimore dhe Metodikave H.A.C.C.P”.*
 4. *Vërtetim i bazes së Vlerësuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore 27.01.2026*

Për plotësimin e kriterit OE “DION-AL” shpk ka paraqitur dokumentacion për Kuzhinierin e deklaruar:

- *Znj. L. B. ka paraqitur Kontratë Individuale të punës, si dhe certifikatat/dëshmitë si më poshtë:*
 1. *Certifikatë kursi për “Kuzhinier” Diplomë e Shkollës Shtetërore të Mesme Dega Kuzhinë Nr. i Amzës 1886 datë 16.08.1979*
 2. *Certifikatë Trajnimi “Trajnim HACCP (Niveli 2-4)”*,
 3. *Certifikatë Trajnimi “Trajnim ISO 22000 - Food Safety Management”*,
 4. *Vërtetim i bazes së Vlerësuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore 24.01.2026*
 5. *CV e Kuzhinierit*

Për plotësimin e kriterit OE “DRIVE EXPERT ALBANIA” shpk ka paraqitur dokumentacion për Kuzhinierin e deklaruar:

- *Znj. N. M. ka paraqitur Kontratë Individuale të punës, si dhe certifikatat/dëshmitë si më poshtë:*

1. *Certifikatë e Kursit të Unifikuar “Kuzhinë” lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional datë 09.05.2023*
2. *Librezë Pune ku figuron vetëm marrëdhëia e punës pranë DRIVE EXPERT ALBANIA sh.p.k nga viti 2022.*

Referuar dokumentacionit të paraqitur nga secili operator ekonomik listuar si më sipër, KVO vijoi me pikëzimin për secilin operator, sipas parashikimeve të shkronjës b), pika 8 e nenit 45 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, të ndryshuar, konkretisht:

$Pk1 = Ok1 \times Pmax1 / Vmax k1$

Vmax1 ____ vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet;

Pmax1 ____ pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet;

Ok1 ____ treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

1. *OE “4 S” shpk dhe OE “DION-AL” shpk kanë paraqitur secili nga 3 (tre) dokumente të kualifikimit profesional për kuzhinierin dhe në këto kushte vlerësohet secili me pikët maksimale, 5 (pesë) pikë.*
2. *OE “DRIVE EXPERT ALBANIA” shpk ka paraqitur 1 (një) dokument të kualifikimit profesional për kuzhinierin dhe bazuar në formulën e aplikueshme vlerësohet me 1.67 (një pikë gjashtëdhjetë e shtatë) pikë.*

b. Përvoja (Eksperiencia) e kuzhinierit 0 - 5 pikë

Përvoja profesionale mbi 2 vite është e rëndësishme për disa arsye teknike, pasi siguron zotërimin praktik të teknikave të gatimit dhe përdorimit të pajisjeve profesionale, ndihmon në standartizimin e recetave/dietave ditore, duke garantuar sasi, cilësi, dhe kalori të përcaktuara nga AK, rrit sasinë dhe efikasitetin në kushte intensive pune pa kompromentuar sigurinë ushqimore, ndikon në reduktimin e mbetjeve të gjeneruara nga ushqimi.

Përvoja mbi 2 vite pune tregon se kuzhinieri zotëron aftësi për punë të pavarur, menaxhim të proceseve të gatimit, bashkëpunimin efektiv me stafin e kuzhinës

Metoda e verifikimit:

Eksperiencia minimale në punë të ngjashme për kuzhinierin është 2 vite, vitë të vlerësuara si periudha minimale e nevojshme për t’u familjarizuar me: ciklet e punës së pajisjeve, kontrollin e temperaturave, procedurat e sigurisë gjatë përdorimit. Këto njohuri teknike nuk fitohen vetëm nëpërmjet formimit teorik, por kërkojnë praktikë reale pune. Nëse kjo eksperiencë është 2 vite ose më pak, oferta nuk merr asnjë pikë.

Me 10 pikë do të vlerësohen ofertesit të cilët do të dëshmojnë se kanë në stafin e tyre kuzhinier me përvojën më të lartë, sepse përvoja më e lartë në punë tregon rritje profesionale, përmirëson efikasitetin dhe cilësinë e shërbimit, reflekton ekspertizë të konsoliduar dhe përvojë në kushte intensive pune. Ofertesit e tjerë vlerësohen sipas formulës në rend zbritës.

Dokumentet për verifikim:

Për të përmbushur këtë kërkesë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- *Librezë pune/deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ cv dhe/ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton eksperiencën në shërbime të ngjashme.*

Për plotësimin e kriterit OE “4 S” shpk ka paraqitur dokumentacion për Kuzhinierin e deklaruar, Znj. E.S., si më poshtë:

1. *Deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale (Vërtetim për bazën e vlerësuar).*

Referuar dokumentit të mësipërm, rezulton se në total punonjësi i deklaruar ka një eksperiencë prej 26 muajsh, duke e plotësuar kriterin minimal prej 2 (dy) vitesh për të marrë pjesë në pikëzim. .{Sqarojmë se. eksperiencia prej 26 muaj është llogaritur referuar.

- a) *Periudhën nga momenti kur i lind e drejta të punojë në profesion Kuzhinë datë 23.02.2026 (data e kompletimit të kursit Kuzhinë).*
- b) *Eksperiencën e plotë pranë subjektit 4 S sh.p.k i cili ka aktivitet bar-restorant ushqim të gatuar të licensuar.*

Për plotësimin e kriterit OE “DION-AL” shpk ka paraqitur dokumentacion për Kuzhinierin e deklaruar, Znj. L.B., si më poshtë:

1. *Libreze pune*
2. *CV (ku rezultojnë periudhat gjatë të cilave Znj. L.B. ka punuar si Kuzhiniere*
3. *Deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale (Vërtetim për bazën e vlerësuar).*

Referuar dokumentit të mësipërm, rezulton se në total punonjësi i deklaruar ka një eksperiencë prej 156 muajsh, duke e plotësuar kriterin minimal prej 2 (dy) vitesh për të marrë pjesë në pikëzim.

Për plotësimin e kriterit OE “DRIVE EXPERT ALBANIA” shpk ka paraqitur dokumentacion për Kuzhinierin e deklaruar, Znj, N. M., si më poshtë:

1. *Librezë pune;*
- Referuar dokumentit të mësipërm, rezulton se në total punonjësi i deklaruar ka një eksperiencë prej 46 muajsh, duke e plotësuar kriterin minimal prej 2 (dy) vitesh për të marrë pjesë në pikëzim.*

Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga secili operator ekonomik listuar si më sipër, KVO vijoi me pikëzimin për secilin operator, sipas parashikimeve të shkronjës b), pika 8 e nenit 45 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, të ndryshuar, konkretisht:

$$Pk1 = Ok1 \times Pmaxk1 / Vmax k1$$

Vmaxk1 ____ vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet;

Pmaxk1 ____ pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet;

Ok1 ____ treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

1. Kuzhinieri i delaruar nga OE "DION-AL" shpk ka në total 156 muaj eksperiencë dhe në këto kusht vlerësohet me pikët maksimale, 5 (pesë) pikë.
2. Kuzhinieri i delaruar nga OE "DRIVE EXPERT ALBANIA" shpk ka në total 46 muaj eksperiencë dhe bazuar në formulën e aplikueshme vlerësohet me 1.47 (një pikë dyzet e shtatë) pikë.
3. Kuzhinieri i delaruar nga OE "4 S" shpk ka në total 26 muaj eksperiencë dhe bazuar në formulën e aplikueshme vlerësohet me 0.83 (zero pikë tetëdhjetë e tre) pikë.

Tabela e pikëve për secilin kriter dhe nënkriter

NR	SUBJEKTI	Oferta	Kuafikimi dhe përvoja e Kryekuzhinierit		Kuafikimi dhe përvoja e Kuzhinierit	
			Kualifikimi profesional	Përvoja (Eksperiencia) e kryekuzhinierit	Kualifikimit profesional	Përvoja (Eksperiencia) e kuzhinierit
1	"4 S" shpk	75	3.75	2.41	5	0.83
2	"DION-AL" shpk	68.80	5	10	5	5
3	"DRIVE EXPERT ALBANIA" shpk	65.99	1.25	4.48	1.67	1.47

Mbas kësaj bazuar në nenin 92 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", të ndiyshuar dhe të nenit 82, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndiyshuar, në përfundim, të shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit ligjor, teknik dhe ekonomik për procedurën: 4, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, VENDOSI të bëjë klasifikimin e ofertave të kualifikuara si më poshtë:

Renditja	SUBJEKTI	Pikë totale
I	"DION-AL" shpk	93.80
II	"4 S" shpk	86.99
III	"DRIVE EXPERT ALBANIA" shpk	74.86

...

Për transparence po ju paraqesim një tabelë me pikët e KVO dhe pikët e SPE . Sqarojmë se në SPE pikët paraqiten në total duke shumëzuar pihët e marë nga operatori nie numrin e anëtarëve të KVO , në rastin konkret pikët e OE shumëzohen me 3:

Renditja	SUBJEKTI	Pikët në SPE	Pikët e KVO x3
I	"DION-AL" shpk	282	281.4
II	"4 S" shpk	261	260.97
III	"DRIVE EXPERT ALBANIA" shpk	22.55	224.58

Pas përfundimit të procesit të vlerësimit nga të gjithë anëtarët e Komisionit, KVO në zbatim të Shtojcës të DST Formularit të Vetdeklarimit ku përcaktohet se: Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, st dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin, do të procedojë në sistemin elektronik app.gov.al me njoftimin e operatorit ekonomik "DION-AL" shpk., i renditur i pari, për detyrimin e dorëzimit të dokumentacionit fizik dhe provues brenda afateve ligjore."

III.1.7. Në nenin 2 "Qëllimi" të ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik", parashikohet shprehimisht se:

"Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik."*

III.1.8. Ndëkohë në nenin 3 "Parime të përgjithshme" të ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik", parashikohet shprehimisht se:

- "1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën."*

III.1.9. Neni 21 pika 1 "Autoriteti ose enti kontraktor" i ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: "Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj."

III.1.10. Në nenin 87 të ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme.

2. Oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenin 88 të këtij ligji, dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kriterëve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale. Kriteret e tilla mund të përfshijnë:

a) cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij;

b) organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës; ose

c) shërbimin pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet e dorëzimit, si, për shembull, datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit. Elementi i kostos, gjithashtu, mund të marrë formën e një çmimi ose kostoje fikse, mbi bazën e të cilit operatorët ekonomikë do të konkurrojnë vetëm për kriteret e cilësisë.

3. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese konsiderohen se janë të lidhura me objektin e kontratës, kur ato lidhen me punët, furnizimet ose shërbimet që do të ofrohen në zbatim të asaj kontrate në çdo drejtim dhe në çdo fazë të ciklit të tyre jetësor, duke përfshirë faktorët që bëjnë pjesë në:

a) procesin specifik të prodhimit, ofrimit ose tregtimit të atyre punëve, furnizimeve ose shërbimeve; ose

b) një proces specifik, për një fazë tjetër të ciklit të tyre jetësor, edhe kur këta faktorë nuk janë pjesë e substancës së tyre thelbësore.

4. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk i japin autoritetit ose entit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Në rast dyshimi, autoritetet ose entet kontraktore verifikojnë saktësinë e informacionit dhe provat e paraqitura nga ofertuesit.

5. Autoriteti ose enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i jep çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme, me përjashtim të rasteve kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e çmimit. Nëse përcaktimi i shkallës së rëndësisë nuk është i mundur për arsye objektive, autoriteti ose enti kontraktor i paraqet kriteret sipas rëndësisë në rend zbritës.”.

III.1.11. Në nenin 92 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet

asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji. 4. Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.”.

III.1.12. Në nenin 45 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“1. Autoriteti/enti kontraktor përcakton dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme.

2. Oferta, ekonomikisht më e favorshme, identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenet 87 dhe 88 të LPP-së dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kriterëve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale.

2.1. Për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, në rastet kur oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët, ky i fundit përlllogaritet bazuar në:

a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date;

b) elementet fiskale;

c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës.

3. Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme, bazohet në çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave.

4. Në kontratat që përveç çmimit për punën/mallin/shërbimin, objekt i kontratës, përmban dhe elemente të tjera, që kanë vlerë ekonomike dhe i ngarkojnë autoritetit/entit kontraktor shpenzime gjatë fazës së zbatimit të saj ose dhe më tej, kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme bazohet në:

a) cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij; dhe/ose

b) organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës; dhe/ose

c) shërbimin koston pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet e dorëzimit, si p.sh. datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.

5. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese konsiderohen se janë të lidhura me objektin e kontratës, kur ato lidhen me punët, furnizimet ose shërbimet që do të ofrohen në zbatim të asaj kontrate në çdo drejtim dhe në çdo fazë të ciklit të tyre jetësor, duke përfshirë faktorët që bëjnë pjesë në:

a) procesin specifik të prodhimit, ofrimit ose tregtimit të atyre punëve, furnizimeve ose shërbimeve; ose

b) një proces specifik, për një fazë tjetër të ciklit të tyre jetësor, edhe kur këta faktorë nuk janë pjesë e substancës së tyre thelbësore.

6. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit, të verifikohen, për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Në rast dyshimi, autoriteti/enti kontraktor verifikon saktësinë e informacionit dhe provat e paraqitura nga ofertuesit.

7. Autoriteti/enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i jep çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme, me përjashtim të rasteve kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e çmimit.

8. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehesh në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.

Në rastin kur, oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të koston, autoriteti ose enti kontraktor duhet të argumentojë dhe dokumentojë vendosjen e çdo kriteri që do të përdoret, si dhe peshën specifike për secilin kriter, konkretisht, pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyrën e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm. Formula që zbatohet për llogaritjen e pikëve është si më poshtë:

$$Po = Pk1 + Pk2 + Pk3 + \dots$$

Po - janë pikët totale të ofertës së vlerësuar

Pk1/Pk2/Pk3/... - janë pikët për secilin kriter të vlerësuar, që mund të jetë kriter me trend zbritës ose me trend rritës

a) Në rastet e vlerësimit të ofertës ekonomikisht më të favorshme, për kriteret me trend zbritës, zbatohet formula si më poshtë:

$$Pk1 = Vmink1 \times Pmax1 / Ok1$$

Pk1 _____ Pikët e kriterit që vlerësohet Vmink1 Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet

Pmax1 _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok1 _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

b) Në rastet e vlerësimit të ofertës ekonomikisht më të favorshme, për kriteret me trend rritës, zbatohet formula si më poshtë:

$$Pk1 = Ok1 \times Pmax1 / Vmax k1$$

V_{maxI} _____ Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet

P_{maxI} _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

OkI _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

9. Në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme, kriter për shpalljen e ofertës fituese do të jetë “oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto”, ku çmimi do të ketë jo më pak se 20 pikë dhe propozimi teknik jo më pak se 80 pikë. Çdo kriter vlerësohet në një shkallë nga 1 deri në 100 dhe më tej, pesha e tyre kthehet në pikë përkatëse.

Oferta më e mirë do të jetë sipas kombinimit të pikëve të propozimit teknik dhe propozimit ekonomik. Formula e llogaritjes është: $Oferta\ më\ e\ mirë = X + Y$

Pesha për Propozimin Teknik: $X = (\text{pikët e propozimit teknik} \times 0.8)$

Pesha për Propozimin Ekonomik: $Y = (\text{pikët e propozimit ekonomik} \times 0.2)$

a) Për kriteret, që mund të përdoren për propozimet teknike, autoriteti ose enti kontraktor mund të marrë parasysh kriteret e mëposhtme:

i. Përvoja për punë të ngjashme të konsulentit;

ii. cilësinë e metodologjisë së propozuar;

iii. kualifikimet e stafit kryesor të propozuar.

Nënkriteret e kriterëve të vlerësimit teknik do të përcaktohen në dokumentet standarde të tenderit për shërbimet.

b) Vlerësimi i propozimeve ekonomike kryhet sipas formulës së mëposhtme:

P_e - Pikët për propozimin ekonomik

$\Ç_u$ - Çmimi më i Ulët i Ofruar

$\Ç$ - Çmimi Ofertues i Radhës (duke filluar nga çmimi më i ulët)

$P_e = 100 \times \frac{\Ç_u}{\Ç}$ (çmimi më i ulët = pikët maksimale për propozimin ekonomik).”.

III.1.13. Në nenin 75 “Komisioni i vlerësimit të ofertave” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“1. Komisioni i vlerësimit të ofertave emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit/entit kontraktor dhe përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) persona me arsim të lartë, ku të paktën njëri është ekspert i fushës, nëse nevojitet për objektin e prokurimit. Në rastin e prokurimit të kontratave të shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme, të gjithë anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave duhet të jenë ekspertë të fushës së objektit që prokurohet.

2. Personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit nuk mund të emërohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave.

3. Një prej anëtarëve të komisionit caktohet kryetar dhe është përgjegjës për fillimin e punës menjëherë pas krijimit të komisionit.

Në çdo rast, numri i anëtarëve duhet të jetë tek.

Në rastin e mungesës së personelit, autoriteti/enti kontraktor mund të punësojë me kontratë ekspertë të jashtëm, si anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave.

4. Komisioni është përgjegjës për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave. Anëtarët e komisionit duhet të zbatojnë detyrat në pavarësi të plotë. Nëse kërkohen sqarime për dokumentet e tenderit, këto merren nga njësia e prokurimit.

Në çdo rast, përgjegjësia për vlerësimin e ofertave është e komisionit të vlerësimit të ofertave. Përjashtimisht, nëse komisioni i vlerësimit të ofertave vlerëson dhe argumenton se një ose disa kritere janë hartuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit dhe/ose legjislacionin e fushës në fuqi, ka të drejtë t'i propozojë titullarit anulimin e procedurës. Anëtarët e komisionit nuk kryejnë asnjë veprim tjetër, përveç atyre të përcaktuara shprehimisht në këto rregulla.”.

III.1.14. Në nenin 80 “Hapja e ofertave” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“1. Komisioni i vlerësimit të ofertave hap dhe lexon ofertat në përputhje me nenin 90, të LPP-së, dhe me përcaktimet në këto rregulla.

2. Në momentin e hapjes së ofertave, zyrtarët e përfshirë në procesin e vlerësimit të ofertave nënshkruajnë një deklaratë, përmes së cilës deklarojnë se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me ofertuesit pjesëmarrës.

Nëse evidentohet se një ose disa prej operatorëve ekonomikë ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me një ose disa prej zyrtarëve të caktuar për vlerësimin e ofertave, atëherë duhet të zëvendësohet zyrtari/zyrtarët në fjalë dhe më pas të vazhdojë procesi i prokurimit.

3. Personi përgjegjës për prokurimin, anëtar i njësisë së prokurimit, mund të jetë i pranishëm gjatë fazës së hapjes së ofertave duke kryer funksione të karakterit ndihmës, si mbajtja e procesverbalit, sistemimi dhe ruajtja e dokumenteve.

4. Në rastin kur procedura zhvillohet në formë shkresore, komisioni i vlerësimit të ofertave lexon emrin dhe adresën e ofertuesit dhe hap zarfin përkatës. Më pas, lexohet me zë të lartë oferta ekonomike dhe lista e dokumenteve ligjore, administrative dhe kualifikuese të paraqitura nga ofertuesi. Procesverbali dhe një vërtetim, që pasqyron të gjitha dokumentet, që shoqërojnë ofertën e tij duhet t'i vihet në dispozicion në bazë të kërkesës çdo ofertuesi, ndërsa ofertuesve që kanë paraqitur ofertë, por që nuk janë të pranishëm ose të përfaqësuar në hapjen e ofertave, duhet t'u dërgohet njoftim për hapjen e procedurës.

Oferta ekonomike nënshkruhet në pjesën e pasme të fletës nga të gjithë anëtarët e komisionit. Çdo hap i procedurës së prokurimit duhet të regjistrohet dhe të pasqyrohet në procesverbal. Personi përgjegjës për prokurimin, anëtar i njësisë së prokurimit është përgjegjës për regjistrimin e çdo faze të procesit dhe teksti përfundimtar i tij duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave.

5. Nëse anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave kanë mendime të ndryshme ose nëse komisioni vendos me votim, kjo gjë duhet të dokumentohet. 6. Dokumentet që shoqërojnë ofertën nuk u kthehen ofertuesve, por mbeten pjesë e dosjes së procedurës dhe administrohen, në përputhje me nenin 21, të LPP-së.”.

III.1.15. Në nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“1. Kohëzgjatja e procedurës së vlerësimit nuk duhet të kalojë 20 (njëzet) ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe 15 (pesëmbëdhjetë) ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar, përveç rasteve të tjera të cilësuar ndryshe në këto rregulla.

Në rast se komisionit të vlerësimit të ofertave i lind nevoja për verifikime ose ndryshime të një apo më shumë anëtarëve, afati i vlerësimit pezullohet në momentin e paraqitjes së kërkesës për verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku është pezulluar, me marrjen e përgjigjes apo zyrtarizimit të anëtarit/ve.

2. Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:

i. “devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit;

ii. “rezervimi” është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe

iii. “mospranimi” është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit.

Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë.

3. Ofertat e kualifikuara verifikohen nëse kanë apo jo gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike korrigjohen në mënyrën e mëposhtme:

a) nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij; Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.

b) nëse ka ndonjë mospërputhje të çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij; Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin

c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga kjo rregull situata kur shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përlllogaritjen e zërave të ofertës.

Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;

- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve janë më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

4. Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;

- në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e lartë monetar, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e lartë monetar, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së.

Formula që duhet zbatuar për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është, si më poshtë vijon:

O – Oferta MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N – Numri i ofertave të vlefshme

$PR (Zm)$ – Zbritje e mundshme MO = $O1 + O2 + O3 + \dots On/N$

$PR = 85 \% Mo$

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.”

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/et e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.

5. Në rastin e procedurave të prokurimit me faza, komisioni i vlerësimit të ofertave lexon emrin dhe adresën e kandidatit dhe listën e të gjitha dokumenteve të kualifikimit, të paraqitura prej tij. Jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe 10 (dhjetë) ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar, nga data e dorëzimit të dokumentacionit të kërkuar, komisioni i vlerësimit përcakton listën përfundimtare të kandidatëve të kualifikuar, që do të vlerësohen për ofertën dhe ia komunikon këtë informacion menjëherë të gjithë kandidatëve, që kanë paraqitur kërkesë për pjesëmarrje. Kandidatëve të kualifikuar, në përfundim të afateve të ankimit, u dërgohet një ftesë për ofertë, në përputhje me nenin 58, të LPP-së.

Më pas, komisioni i vlerësimit të ofertave vazhdon vlerësimin e ofertave teknike të kandidatëve të kualifikuar dhe bën klasifikimin teknik.

Në varësi të llojit të procedurës së prokurimit, komisioni i vlerësimit të ofertave, në varësi të kompleksitetit të kontratës, mund të zhvillojë negociata në fazë të ndryshme me secilin nga kandidatët e përzgjedhur, por gjithmonë duhet të pasqyrojë përmbajtjen e tyre në procesverbalin përkatës.

Komisioni i vlerësimit të ofertave kalon në shqyrtimin e ofertës ekonomike dhe verifikon nëse ka gabime aritmetike apo çmim anomalisht të ulët, sipas përcaktimeve në pikat 3 dhe 4, të këtij neni.

Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë vetëm me shkrim ose të pasqyruara në procesverbal.

Në bazë të ofertave të pranuar, komisioni i vlerësimit të ofertave merr vendim për shpalljen e fituesit, i cili publikohet në sistemin e prokurimit elektronik menjëherë, por jo më vonë se 7 (shtatë) ditë pas përfundimit të procedurës së vlerësimit.

Në rastin e procedurave me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, afatet për vlerësimin e ofertave përcaktohen nga autoriteti kontraktor, në varësi të kompleksitetit të kontratës dhe situatës konkrete.

6. Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë pikë të njëjta, atëherë fituesi do të përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Njoftimi për datën dhe orën e hedhjes së shortit u njoftohet ofertuesve. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën shkak për skualifikim.”.

III.1.16. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.17. Në rastin konkret, lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “4 S” SHPK përsa i përket vlerësimit me pikë të ofertës së dorëzuar prej tij në këtë procedurë prokurimi, si dhe përsa i përket vlerësimit me pikë të ofertës së operatorit ekonomik ofertues “DION-AL” SHPK dhe ofertës së operatorit ekonomik *DRIVE EXPERT ALBANIA*” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor në pikën 4.4 “*Kriteret e përzgjedhjes së fituesit*” të Seksionit 4 “*Procedura*” të dokumenteve të tenderit të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt ankimi ka përcaktuar si metodologji për përcaktimin e ofertës fituese metodën “*Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto*”, duke përcaktuar 5 (pesë) kriteret të përzgjedhjes së ofertës fituese dhe konkretisht, si në vijim: “*Kriterin “Çmimi” duke e pëshuar me 0-75 pikë; Kriterin “Kualifikimi dhe përvoja e stafit (Kryekuzhinier dhe kuzhinier)” duke e pëshuar me 0-25 pikë, kriter të cilin e ka ndarë në 4 (katër) nënkritere dhe konkretisht nënkriteri “Kualifikimi profesional i kryekuzhinierit” duke e pëshuar me 0-5 pikë, nënkriteri “Përvoja (Eksperienca) e kryekuzhinierit” duke e pëshuar me 0-10 pikë, “Kualifikimi profesional i kuzhinierit” duke e pëshuar me 0-5 pikë dhe*

nënkriteri “Përvoja (Eksperienca) e kuzhinierit” duke e peshuar me 0-5 pikë. ”, si dhe ka publikuar metodologjinë e përlogaritjes së pikëve për secilin kriter dhe nënkriter vlerësimi. Gjithashtu nga shqyrtimi i kritreve të vlerësimit të sipërpërmendura Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor në pikën 4.4 “Kriteret e për zgjedhjes së fituesit” të Seksionit 4 “Procedura” të dokumenteve të tenderit të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt ankimi ka përcaktuar se vlerësimi me pikë i kritereve të vlerësimit do të bëhet si në vijim: “Kriterin “Çmimi” do të bëhet mbi bazën e ofertës ekonomike të dhënë nga operatorët ekonomikë ofertues të kualifikuar referuar Shtojcës 1 “Formulari i Ofertës Ekonomike”, ku operatori ekonomik që ka dorëzuar ofertën ekonomike më të ulët do të marrë pikët maksimale (75 pikë), ndërsa operatorët me ofertë më të lartë do të marrin pikët referuar formulës përkatëse të publikuar në këtë seksion të dokumentave të tenderit të modifikuara; nënkriteri “Kualifikimi profesional i kryekuzhinierit” do të bëhet bazuar kualifikimet profesionale lidhur me nivelin minimal arsimor për ushtrimin e profesionit të kuzhinierit, lidhur me njohuritë për praktikën më të mira higjieno-sanitare, HACCP, siguri ushqimore, menaxhim kuzhine, planifikim menuje, me zbatimin e standarteve kombëtare e ndërkombëtare, teknika praktike gatimi, menaxhim kuzhine, teknologjia ushqimore dhe inovacionet në gatim, ndërgjegjësim për mjedisin dhe qëndrueshmërinë, etj vërtetuar me diploma profesionale ose certifikata profesionale ose certifikata trajnimit apo cdo dokument tjetër që provon kualifikime/trajnime në fusha që lidhen me profesionin e kryekuzhinierit dhe objektin e prokurimit, të lëshuara nga organe të akredituara/të njohura kombëtare apo ndërkombëtarisht, ku operatori ekonomik ofertues i kualifikuar që disponon në stafin e tij një person me detyrën “Kryekuzhinier” me numrin më të madh të kualifikimeve të kërkuara do të marrë pikët maksimale (5 pikë) ndërsa operatorët e tjerë ekonomik të kualifikuar do të marrin pikët referuar numrit të kualifikimeve të kërkuara që ka personi me detyrën “Kryekuzhinier” që disponon në stafin e tij dhe formulës përkatëse të publikuar në këtë seksion të dokumentave të tenderit të modifikuara; nënkriteri “Përvoja (Eksperienca) e kryekuzhinierit” do të bëhet bazuar në përvojën e personit me detyrën “Kryekuzhinier” që disponon operatori ekonomik ofertues i kualifikuar, ku përvoja minimale që duhet të ketë për efekt vlerësimi me pikë është 5 (pesë) vite dhe vitet e përvojës në shërbime të mëparshme të ngjashme vërtetuar me librezë punë ose deklaratë e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – Albania ose CV-i ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton eksperiencën në shërbime të ngjashme, ku operatori ekonomik ofertues i kualifikuar që disponon në stafin e tij një person me detyrën “Kryekuzhinier” me periudhën më të gjatë kohore të eksperiencës të ngjashme me eksperiencën e kryekuzhinierit do të marrë pikët maksimale (10 pikë), ndërsa operatorët e tjerë ekonomik të kualifikuar do të marrin pikët referuar me periudhës kohore të eksperiencës të ngjashme me eksperiencën e kryekuzhinierit që ka personi me detyrën “Kryekuzhinier” që disponon në stafin e tij dhe formulës përkatëse të publikuar në këtë seksion të dokumentave të tenderit të modifikuara; nënkriteri “Kualifikimi profesional i kuzhinierit” do të bëhet bazuar aftësinë praktike, përgatitjen teknike dhe njohuritë shtesë të kuzhinierit që do të jetë përgjegjës për përgatitjen e përditshme të ushqimit, në aftësinë profesionale për zbatimin e saktë të standardeve higjieno-sanitare në praktikë, në aftësinë profesionale mbi higjienën ushqimore, temperaturat e ruajtjes, menaxhimin e produkteve dhe ndarjen e ushqimeve të papërpunuara nga ato të gatuar, në aftësinë profesionale për parandalimin e ndotjeve dhe mbajtjen e cilësisë

ushqimore, lidhur me aftësinë profesionale për teknikat moderne të gatimit, përdorimit të pajisjeve profesionale, dhe përgatitjen dietetike të ushqimeve të gatuar, në aftësinë profesionale për përgatitjen e ushqimit në mënyrë të shpejtë, të shëndetshme dhe me standard të qëndrueshëm, në aftësinë profesionale për përgatitjen e vakteve sipas sasise dhe kalorive të përcaktuara në specifikimet teknike dhe në aftësinë profesionale për të garantuar që shërbimi të mbetet brenda standarteve ushqimore, edhe në kushte pune me volum të lartë ose dinamikë të ndryshme, vërtetuar me certifikata profesionale ose certifikata trajnime apo cdo dokument tjetër që provon kualifikime/trajnime në fusha që lidhen me profesionin e kryekuzhinierit dhe objektin e prokurimit, të lëshuara nga organe të akredituara/të njohura kombëtare apo ndërkombëtarisht, ku operatori ekonomik ofertues i kualifikuar që disponon në stafin e tij një person me detyrën “Kuzhinier” me numrin më të madh të kualifikimeve të kërkuara do të marrë pikët maksimale (5 pikë) ndërsa operatorët e tjerë ekonomik të kualifikuar do të marrin pikët referuar numrit të kualifikimeve të kërkuara që ka personi me detyrën “Kuzhinier” që disponon në stafin e tij dhe formulës përkatëse të publikuar në këtë seksion të dokumentave të tenderit të modifikuara, si dhe nënkriteri “Përvoja (Eksperiencia) e kuzhinierit” do të bëhet bazuar në përvojën e personit me detyrën “Kryekuzhinier” që disponon operatori ekonomik ofertues i kualifikuar, ku përvoja minimale që duhet të ketë për efekt vlerësimi me pikë është 2 (dy) vite dhe vitet e përvojës në shërbime të mëparshme të ngjashme vërtetuar me librezë punë ose deklaratë e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – Albania ose CV-i ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton eksperiencën në shërbime të ngjashme, ku operatori ekonomik ofertues i kualifikuar që disponon në stafin e tij një person me detyrën “Kuzhinier” me periudhën më të gjatë kohore të eksperiencës të ngjashme me eksperiencën e kryekuzhinierit do të marrë pikët maksimale (5 pikë), ndërsa operatorët e tjerë ekonomik të kualifikuar do të marrin pikët referuar me periudhës kohore të eksperiencës të ngjashme me eksperiencën e kryekuzhinierit që ka personi me detyrën “Kuzhinier” që disponon në stafin e tij dhe formulës përkatëse të publikuar në këtë seksion të dokumentave të tenderit të modifikuara.”.

III.1.18.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “4 S” SHPK përsa i përket vlerësimit me pikë të nënkriterit “Kualifikimi profesional i kryekuzhinierit” të ofertës së paraqitur prej tij, si dhe lidhur me pretendimet e tij për vlerësimin me pikë të ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë ofertues të kualifikuar “DION-AL” SHPK dhe “DRIVE EXPERT ALBANIA” SHPK, Komisioni referuar nënkriterit të vlerësimit të përcaktuar në pikën 4.4 “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit” të Seksionit 4 “Procedura” të dokumenteve të tenderit të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt ankimi, dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë të sipërpërmendur dhe të pasqyruar në pikën III.1.3., të këtij vendimi, si dhe procesverbalit të vlerësimit të ofertave të mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në datë 11.02.2026, konstatohet si më poshtë vijon:

- Operatori ekonomik i kualifikuar “4 S” SHPK për këtë nënkriter vlerësimi referuar Seksioni B: “DEKLARATË ‘Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohet)’” të Pjesës III: “Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit” të Shtojcës 10 “FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT” ka deklaruar se kryekuzhinier është z. D. D, ku për të vërtetuar aftësitë profesionale që zotëron ky i fundit ka dorëzuar gjithsej 3 (tre) certifikata ku nga shqyrtimi i Certifikatës Nr. XXX, datë 01.10.2025 dhe i Certifikatës

Nr. 28112025, datë 30.01.2026 konstatohet se ky punonjës zotëron gjithsej 16 (gjashtëmbëdhjetë) kualifikime profesionale, përkatësisht si në vijim: *“Identifikimi dhe menaxhimi i pikave kritike të kontrollit në sigurinë ushqimore; Hartimi i dokumentacionit HACCP në sektorë të ndryshëm ushqimor; implementimi i dokumentacionit HACCP në sektorë të ndryshëm ushqimor; rregjistrimi i dokumentacionit HACCP në sektorë të ndryshëm ushqimor; kontrolli i dokumentacionit HACCP në sektorë të ndryshëm ushqimor; Legjistacioni ushqimor në Shqipëri; Analizimi i risqeve të sigurisë ushqimore; Siguria ushqimore; Cilësia ushqimore; Teknologjitë ushqimore; Baza ligjore për OBU-t; Kërkesat e HACCP-it; Praktikrat e mira të punës; PMP dhe Praktikrat e mira të higjenës dhe PMH.”*, ndërkohë nga shqyrtimi i Certifikatë Nr. Amzës: XXX, datë 22.04.2010, e lëshuar nga Subjekti Privat i Formimit Profesional *“VITRINA”*, ku vërtetohet se z. D. D ka përfunduar kursin *“Kuzhinier”* nuk konstatohet se çfarë aftësisësh profesionale ka fituar ku individ referuar kurrikulës apo programit mësimor që përfshin kjo certifikatë.

- Operatori ekonomik i kualifikuar *“DION-AL”* SHPK për këtë nënkriter vlerësimi refruar Seksioni B: *“DEKLARATË ‘Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohet)’”* të Pjesës III: *“Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit”* të Shtojcës 10 *“FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT”* ka deklaruar se kryekuzhinier janë 2 (dy) persona dhe përkatësisht z. Vangjel Sharko dhe znj. Ë. P (M), ku z. V. Sh për të vërtetuar aftësitë profesionale ka dorëzuar gjithsej 1 (një) dëshmi kualifikimi dhe 2 (dy) certifikata kualifikimi ku nga shqyrtimi i Dëshmi kualifikimi nr. Amzës: XXX, lëshuar në datën 16.08.1979, Certifikatës Nr. XXX, datë 28.03.2025 dhe Certifikatë Nr. XXX, datë 13.03.2025 konstatohet se ky punonjës zotëron gjithsej 31 (*tridhjetë e një*) kualifikime profesionale, përkatësisht si në vijim: *“Teknologji; Kalkulim; Higjenë; Merceollogji; Organizim; Planifikim; Paisje; Projektim; Praktikë profesioni; Hyrje në Sigurinë Ushqimore; Rreziqet mikrobiologjike të ushqimit; Rreziqet kimike dhe fizike; Menaxhimi i aleggjeneve; Kontaminimi dhe Kontaminimi i kryqëzuar; Higjena personale; Kontrrolli i kohës dhe temperaturës; Ruajtja dhe trajtimi i ushqimit; Pastrimi dhe dezinfektimi; Kontrrolli i dëmtuesve; Higjena e pajisjeve dhe objekteve; Praktikrat e sigurta të përgatitjes së ushqimit; Hyrje në ISO 22000; Struktura e sistemit të menaxhimit të sigurisë ushqimore (FSMS); Zhvillimi i proceseve të sistemit të menaxhimit të sigurisë ushqimore; Programet parakushtuese (FPR); Pastrimi dhe higjena; Kontrrolli i dëmtuesve; Menaxhimi i furnizuesve; Higjena personale; Analiza e riskut dhe plani HACCP dhe Marrëdhënia me Codex HACCP, ISO 9001, FSSC 22000.”*, ndërsa znj. Ë. P (M) për të vërtetuar aftësitë profesionale ka dorëzuar gjithsej 1 (një) dëshmi kualifikimi dhe 3 (tre) certifikata kualifikimi ku nga shqyrtimi i Dëshmi kualifikimi nr. Amzës: XXX, lëshuar në datën 16.08.1978, Certifikatë Nr. XXX, datë 13.05.2025, Certifikatë Nr. XXX, datë 06.03.2025 dhe Certifikatë Nr. XXX, datë 28.03.2025 konstatohet se kjo punonjëse zotëron gjithsej 39 (*tridhjetë e nëntë*) kualifikime profesionale, përkatësisht si në vijim: *“Teknologji; Kalkulim; Higjenë; Merceollogji; Organizim; Planifikim; Paisje; Projektim; Praktikë profesioni; Hyrje në ISO 22000; Struktura e sistemit të menaxhimit të sigurisë ushqimore (FSMS); Zhvillimi i proceseve të sistemit të menaxhimit të sigurisë ushqimore; Programet parakushtuese (FPR); Pastrimi dhe higjena; Kontrrolli i dëmtuesve; Menaxhimi i furnizuesve; Higjena personale; Analiza e riskut dhe plani HACCP; Marrëdhënia me Codex HACCP, ISO 9001, FSSC 22000; 4 nivele e trajnimit HACCP (kategoritë, kush përfshihet dhe temat për secilin nivel); Niveli 1*

- HACCP / Ndërgjegjësim për sigurinë ushqimore; Niveli 2 - Parimet HACCP / Siguria Ushqimore për Përpunuesit; Niveli 3 - HACCP i Ndërmjetëm / Mbikqyrës; Niveli 4 - HACCP i Avancuar / Menaxhere; Projektim i Sistemit HACCP; Zhvillimi i Analizës së Rrishtit; Kultura e sigurisë ushqimore dhe kërkesat ligjore; Hyrje në Sigurinë Ushqimore; Rreziqet mikrobiologjike të ushqimit; Rreziqet kimike dhe fizike; Menaxhimi i alergjeneve; Kontaminimi dhe Kontaminimi i kryqëzuar; Higjena personale; Kontrrolli i kohës dhe temperaturës; Ruajtja dhe trajtimi i ushqimit; Pastrimi dhe dezinfektimi; Kontrrolli i dëmtuesve; Higjena e pajisjeve dhe objekteve dhe Praktikën e sigurta të përgatitjes së ushqimit.”.

- Operatori ekonomik i kualifikuar “DRIVE EXPERT ALBANIA” SHPK për këtë nënkriter vlerësimi referuar Seksioni B: “DEKLARATË ‘Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohet)’ ” të Pjesës III: “Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit” të Shtojcës 10 “FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT” ka deklaruar se kryekuzhinier është z. S. H, ku për të vërtetuar aftësitë profesionale që zotëron ky i fundit ka dorëzuar 1 (një) certifikatë ku nga shqyrtimi i Certifikatë datë 12.03.2013, e lëshuar nga Instituti Culinary Albania Professional (ICAP) vërtetohet se z. S. H ka përfunduar kursin “Kuzhinier”, por nuk konstatohet se çfarë aftësishë profesionale ka fituar ky individ referuar kurrikulës apo programit mësimor që përfshin kjo certifikatë.

Referuar procesverbalit të vlerësimit të ofertave të mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në datë 11.02.2026, Komisioni konstaton se komisioni i vlerësimit të ofertave këtë kriter vlerësimi e ka bërë duke ju referuar numrit të certifikatave të dorëzuara nga ana e operatorëve ekonomikë ofertues të kualifikuar për punonjësin e deklaruar që do të kryejë rolin e kryekuzhinierit, ndërkohë që referuar analizës së këtij nënkriteri vlerësimi të parashtruar në pikën III.1.71., të këtij vendimi, Komisioni konstaton se vlerësimi i këtij kriteri nuk është bërë në përputhje me numrin e kualifikimeve profesionale që kanë përfunduar punonjësit në rolin e kryekuzhinierit.

Për më tepër, Komisioni konstaton se komisioni i vlerësimit të ofertave për vlerësimin e këtij nënkriteri vlerësimi përsa i përket ofertës së operatorit ekonomik “DION-AL” SHPK ka marrë në shqyrtim vetëm dokumentacionin e dorëzuar për njërin nga 2 (dy) kryekuzhinierët e deklaruar dhe konkretisht dokumentacionin e znj. E. P (M), pasi nga sikurse konstatohet ky punonjës disponon më shumë kualifikime profesionale.

Nisur nga pretendimet e ankimesit dhe nga sa më sipër, Komisioni gjykon se vlerësimi me pikë i nënkriterit të vlerësimit “Kualifikimi profesional i kryekuzhinierit” nuk është bërë duke ju referuar numrit të kualifikimeve profesionale të lidhura me profesionin e kryekuzhinierit dhe fushat ndihmëse (ushqim, higjienë, siguri ushqimore, menaxhim kuzhine, planifikim menuje, etj.) që disponojnë punonjësit e deklaruar që do të kryejnë detyrën e kryekuzhinierit, sikurse është përcaktuar në pikën 4.4 “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit” të Seksionit 4 “Procedura” të dokumenteve të tenderit të modifikuar të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Për më tepër, nisur nga fakti se Certifikata datë 12.03.2013, e lëshuar nga Instituti Culinary Albania Professional (ICAP) dhe Certifikata Nr. Amzës: xxx, datë 22.04.2010, e lëshuar nga Subjekti Privat i Formimit Profesional “VITRINA” vërtetojnë se mbajtësit e tyre zotërojnë aftësitë profesionale lidhur me kryerjen e profesionit të kuzhinierit, por në këto certifikata

nuk është e mundur që të identifikohen se çfarë lloj aftësish profesionale kanë përfituar mbajtësit e këtyre certifikatave.

Nisur nga sa parashtruar më sipër, Komisioni gjykon se komisioni i vlerësimit të ofertave nuk ka vlerësuar nënkriterin e vlerësimit “*Kualifikimi profesional i kryekuzhinierit*” për ofertat e operatorëve ekonomik të kualifikuar “4 S” SHPK, “DION-AL” SHPK dhe “DRIVE EXPERT ALBANIA” SHPK, duke ju referuar numrit të kualifikimeve profesionale të lidhura me profesionin e kryekuzhinierit dhe fushat ndihmëse (*ushqim, higjienë, siguri ushqimore, menaxhim kuzhine, planifikim menuje, etj.*) të punonjësve të deklaruar që do të kryejnë detyrën e kryekuzhinierit në rast se shpallen fitues, si dhe komisioni i vlerësimit të ofertave nisur nga fakti se Certifikata datë 12.03.2013, e lëshuar nga Instituti Culinary Albania Professional (ICAP) dhe Certifikata Nr. Amzës: xxx, datë 22.04.2010, e lëshuar nga Subjekti Privat i Formimit Profesional “VITRINA” vërtetojnë se punonjësit mbajtës të këtyre certifikatave kanë aftësitë profesionale për të kryer detyrën e kuzhinierit, duke krijuar indicie se këta persona kanë një numër të caktuar kualifikimesh profesionale referuar kurrikulës apo programit mësimor të ndjekur, duhej që sipas përcaktimeve të nenit 92 pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe përcaktimeve të nenit 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar duhej të bënte verifikimet përkatëse pranë institucioneve për të identifikuar numrin e aftësive profesionale që kanë përfituar këta punonjës.

Nisur nga pretendimet e ankimesit, dokumentacionit të përmendur në pikën III.1.3., të këtij vendimi dhe përcaktimeve të autoritetit kontraktor të bëra në pikën 4.4 “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit” të Seksionit 4 “Procedura” të dokumenteve të tenderit të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt ankimi, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor duhet që të identifikojë numrin e kualifikimeve që kanë përfituar mbajtësit e Certifikatës datë 12.03.2013, e lëshuar nga Instituti Culinary Albania Professional (ICAP) dhe Certifikatës Nr. Amzës: XXX, datë 22.04.2010, e lëshuar nga Subjekti Privat i Formimit Profesional “VITRINA”, duke verifikuar kurrikulat ose programin mësimorë të përvetësuar dhe mbi bazën e të cilit janë lëshuar këto certifikata dhe pasi të identifikojë numrin e kualifikimeve që zotëron secili prej punonjësve të deklaruar që do të kryejnë punën e kryekuzhinierit për secilin nga operatorët ekonomikë ofertues të kualifikuar, atëherë të bëjë rivlerësimin me pikë të rivlerësojë me pikë këtë nënkriter vlerësimi, duke i dhënë pikët maksimale (5 pikë) operatorit ekonomik ofertues që disponon në stafin e tij punonjës in që do të kryejë detyrën e kuzhinierit dhe që zotëron numrin më të madhë të kualifikimeve profesionale, ndërkohë që operatorët e tjerë ekonomik të kualifikuar do të marrin pikët referuar numrit të kualifikimeve të kërkuara që ka personi me detyrën “Kryekuzhinier” që disponon në stafin e tij dhe formulës përkatëse të publikuar në këtë seksion të dokumentave të tenderit të modifikuara.

Përsa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes “4 S” SHPK qëndron pjesërisht.

III.1.18.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “4 S” SHPK përsa i përket vlerësimit me pikë të nënkriterit “Përvoja (Eksperienca) e kryekuzhinierit” të ofertës së paraqitur prej tij, si dhe lidhur me pretendimet e tij për vlerësimin me pikë të ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë ofertues të kualifikuar “DION-AL” SHPK dhe “DRIVE

EXPERT ALBANIA” SHPK, Komisioni referuar nënkriterit të vlerësimit të përcaktuar në pikën 4.4 “*Kriteret e përzgjedhjes së fituesit*” të Seksionit 4 “*Procedura*” të dokumenteve të tenderit të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt ankimi, dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë të sipërpërmendur dhe të pasqyruar në pikën III.1.3., të këtij vendimi, si dhe procesverbalit të vlerësimit të ofertave të mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në datë 11.02.2026, konstatohet si më poshtë vijon:

- Operatori ekonomik i kualifikuar “4 S” SHPK për këtë nënkriter vlerësimi refruar Seksioni B: “*DEKLARATË ‘Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohet)’*” të Pjesës III: “*Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit*” të Shtojcës 10 “*FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT*” ka deklaruar se kryekuzhinier është z. D. D, ku për të vërtetuar eksperiencën në punë ky i fundit ka dorëzuar dokumentin “*VËRTETIM PËR BAZËN E VLERËSUAR*” datë 27.01.2026 të lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore identifikohet se ka se ka derdhur kontributet mujore mbi bazën e pagës bruto për 96 (*nëntëdhjet e gjashtë*) muaj, në periudhën e punësimit nga muaji shtator 2015 deri në muajin dhjetor 2025.

- Operatori ekonomik i kualifikuar “*DION-AL*” SHPK për këtë nënkriter vlerësimi refruar Seksioni B: “*DEKLARATË ‘Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohet)’*” të Pjesës III: “*Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit*” të Shtojcës 10 “*FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT*” ka deklaruar se kryekuzhinier janë 2 (dy) persona dhe përkatësisht z. V. Sh dhe znj. Ë. P (M), ku z. V. Sh për të vërtetuar eksperiencën në punë ky i fundit ka dorëzuar dokumentin “*VËRTETIM PËR BAZËN E VLERËSUAR*” datë 22.01.2026 të lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore identifikohet se ka derdhur kontributet mujore mbi bazën e pagës bruto për 101 (*njëqind e një*) muaj, në periudhën e punësimit nga muaji janar 2015 deri në muajin dhjetor 2025, si dhe ka dorëzuar dokumentin “*Jetëshkrim (CV-i)*” ku deklarohet se ka punuar me detyrën e kryekuzhinierit për 156 (*njëqind e pesëdhjet e gjashtë*) muaj, për periudhën kohore 2015 – 2026, ndërsa znj. Ë. P (M) për të vërtetuar eksperiencën në punë ky i fundit ka dorëzuar dokumentin “*VËRTETIM PËR BAZËN E VLERËSUAR*” datë 27.01.2026 të lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore identifikohet se ka derdhur kontributet mujore mbi bazën e pagës bruto për 132 (*njëqind e tridhjet e dy*) muaj, në periudhën e punësimit nga muaji janar 2013 deri në muajin dhjetor 2025, dokumentin “*Jetëshkrim (CV-i)*” ku deklarohet se ka punuar me detyrën e kryekuzhinierit për 324 (*treqind e njëzet e katër*) muaj, si dhe dokumentin “*Librezë pune*” sipas formatit të miratuar nga Instituti i Sigurive Shoqërore për punëmarrësin znj. Ë. P të lëshuar nga punëdhënësi “XXX” SHPK, ku deklarohet se për 116 (*njëqind e gjashtëmbëdhjetë*) muaj ka punuar me detyrën e kuzhinieres.

- Operatori ekonomik i kualifikuar “*DRIVE EXPERT ALBANIA*” SHPK për këtë nënkriter vlerësimi refruar Seksioni B: “*DEKLARATË ‘Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohet)’*” të Pjesës III: “*Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit*” të Shtojcës 10 “*FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT*” ka deklaruar se kryekuzhinier është z. S. H, ku për të vërtetuar eksperiencën në punë ky i fundit ka dorëzuar dokumentin “*VËRTETIM PËR BAZËN E VLERËSUAR*” datë 24.01.2026 të lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore identifikohet se ka derdhur kontributet mujore mbi bazën e pagës bruto për 152 (*njëqind e pesëdhjet e dy*) muaj, në periudhën e punësimit nga muaji janar 2012 deri në muajin dhjetor 2025, si dhe dokumentin “*Jetëshkrim (CV-i)*” ku deklarohet se ka

punuar me detyrën e ndihmëskuzhinierit për 51 (*pesëdhjet e një*) muaj dhe në detyrën e kuzhinierit 131 (*njëqind e tridhjet e një*) muaj.

Referuar procesverbalit të vlerësimit të ofertave të mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në datë 11.02.2026, Komisioni konstaton se komisioni i vlerësimit të ofertave këtë vlerësimin e këtij nënkriteri në rastin e ofertës së operatorit ekonomik “4 S” SHPK e ka bërë duke ju referuar dokumentit “*VËRTETIM PËR BAZËN E VLERËSUAR*” datë 27.01.2026 të lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, ku anëtarët e komisioni të vlerësimit të ofertave kanë konsideruar si muaj eksperience periudhën kohore gjatë së cilës ky punonjës ka punuar pranë subjekteve, të cilat referuar verifikimeve të ekstraktit të rregjistrimit tregtar (sipas numrit NUIS të pasqyruar në këtë vërtetim) në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit kanë në objektin e veprimtarisë, si në vijim “*Kuzhinë, Bar Restaurant Hotel, etj*”, ku në përfundim të këtij verifikimi ka konkluduar se nga 96 (*nëntëdhjet e gjashtë*) muaj eksperiencë pune z. D. D ka eksperiencë pune si kryekuzhinier një periudhë prej 84 (*tetëdhjetë e katër*) muaj, ndërsa në rastin e ofertës së operatorit ekonomik “DION-AL” SHPK vlerësimin e këtij nënkriteri e ka bërë duke ju referuar dokumentit “*Jetëshkrim (CV-i)*”, duke konstatuar se nga 420 (*katërqind e njëzet*) muaj eksperiencë pune znj. Ë. P ka eksperiencë pune si kryekuzhinier një periudhë prej 348 (*treqind e dyzet e tetë*) muaj, ndërkohë që në rastin e ofertës së operatorit ekonomik “DRIVE EXPERT ALBANIA” SHPK vlerësimin e këtij nënkriteri e ka bërë duke ju referuar dokumentit “*VËRTETIM PËR BAZËN E VLERËSUAR*”, duke konstatuar se z. S. H ka eksperiencë pune si kryekuzhinier një periudhë prej 156 (*njëqind e pesëdhjet e gjashtë*) muaj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të përmendur në pikën III.1.3., të këtij vendimi, Komisioni konstaton, si më poshtë:

- Punonjësi z. D. D (*i deklaruar si “Kryekuzhinier” pranë shoqërisë “4 S” SHPK*) për të vërtetuar përvojën në punë si kryekuzhinier ka dorëzuar dokumentin “*VËRTETIM PËR BAZËN E VLERËSUAR*” datë 27.01.2026, i lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, ku nga institucioni shtetëror përgjegjës deklarohet se në periudhën kohore nga muaji shtator 2015 e deri në muajin dhjetor 2025, ky punonjës ka derdhur kontributet mujore mbi bazën e pagës bruto për 96 (*nëntëdhjet e gjashtë*) muaj, duke vërtetuar se ky punonjës ka qënë në marrdhënie pune për 96 (*nëntëdhjet e gjashtë*) muaj, por pa deklaruar detyrën që ka ushtruar përgjatë kësaj periudhe kohore.

- Punonjësi znj. Ë. P (M), (*i deklaruar si “Kryekuzhinier” pranë shoqërisë “DION-AL” SHPK*) për të vërtetuar përvojën në punë si kryekuzhinier ka dorëzuar dokumentin “*Jetëshkrim (CV-i)*”, i cili është një vetëdeklarim i punonjësës znj. Ë. P (M), e cila deklaron se për periudhat vjetore 1995 – 2011 dhe 2016 – e në vazhdim, ka ushtruar profesionin duke kryer detyrën e “*Kryekuzhinieres*” për një periudhë 324 (*treqind e njëzet e katër*) mujore, për periudhën 2013 – 2016 ka ushtruar profesionin duke kryer detyrën e “*Kuzhinieres*” për një periudhë 48 (*dyzet e tetë*) mujore pranë shoqërisë “XXX” SHPK dhe për të njëjtën periudhë ka punuar pranë shoqërisë “XXX” SHPK pa përcaktuar llojin e detyrës që ka ushtruar, ndërkohë që referuar dokumentit “*Librezë pune*” deklarohet se për periudhën 1 janar 2013 – 1 tetor 2019 ka ushtruar profesionin duke kryer detyrën e “*Kuzhinierit*” pranë shoqërisë “XXX” SHPK dhe për periudhën 18 shkurt 2023 e në vazhdim ka ushtruar profesionin duke kryer detyrën e “*Kuzhinierit*” pranë shoqërisë “XXX” SHPK, si dhe referuar dokumentit “*VËRTETIM PËR BAZËN E VLERËSUAR*” datë 27.01.2026, i lëshuar nga Instituti i

Sigurimeve Shoqërore, ku nga institucioni shtetëror përgjegjës deklarohet se në periudhën kohore nga muaji janar 2013 e deri në muajin dhjetor 2025, kjo punonjëse ka derdhur kontributet mujore mbi bazën e pagës bruto për 132 (njëqind e tridhjetë e dy) muaj, duke vërtetuar se ky punonjës ka qënë në marrdhënie pune për 132 (njëqind e tridhjetë e dy) muaj, por pa deklaruar detyrën që ka ushtruar përgjatë kësaj periudhe kohore.

Punonjësi z. V. Sh, (i deklaruar si “Kryekuzhinier” pranë shoqërisë “DION-AL” SHPK) për të vërtetuar përvojën në punë si kryekuzhinier ka dorëzuar dokumentin “Jetëshkrim (CV-i)”, i cili është një vetëdeklarim i punonjësës z. V. Sh, i cili deklaron se për periudhat vjetore 2015-2016, 2016 - 2018, 2018 - 2020, 2021 - 2024 dhe 2025 - e në vazhdim, ka ushtruar profesionin duke kryer detyrën e “Kryekuzhinierit” për një periudhë 156 (njëqind e pesëdhjet e gjashtë) mujore, ndërkohë që referuar dokumentit “VËRTETIM PËR BAZËN E VLERËSUAR” datë 22.01.2026, i lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, ku nga institucioni shtetëror përgjegjës deklarohet se në periudhën kohore nga muaji janar 2015 e deri në muajin dhjetor 2025, ky punonjëse ka derdhur kontributet mujore mbi bazën e pagës bruto për 101 (njëqind e një) muaj, duke vërtetuar se ky punonjës ka qënë në marrdhënie pune për 101 (njëqind e një) muaj, por pa deklaruar detyrën që ka ushtruar përgjatë kësaj periudhe kohore.

- Punonjësi z. S. H, (i deklaruar si “Kryekuzhinier” pranë shoqërisë “DRIVE EXPERT ALBANIA” SHPK) për të vërtetuar përvojën në punë si kryekuzhinier ka dorëzuar dokumentin “Jetëshkrim (CV-i)”, i cili është një vetëdeklarim i punonjësës z. S. H, i cili ka deklaruar se për periudhat vjetore Qershor - Shtator 2008 dhe Dhjetor 2009 - Dhjetor 2013 ka ushtruar profesionin duke kryer detyrën e “Ndihmëskuzhinierit” për një periudhë 53 (pesëdhjet e tre) mujore, ndërsa për periudhat vjetore Janar 2013 - Korrik 2017, Shtator 2017 - Tetor 2018, Tetor 2018 - Nëntor 2019, Nëntor 2019 - Maj 2020, Maj 2020 - Tetor 2020, Tetor 2020 - Dhjetor 2022, Maj 2022 - Shtator 2022 dhe Maj 2023 - Tetor 2023 ka ushtruar profesionin duke kryer detyrën e “Kuzhinierit” për një periudhë 131 (njëqind e tridhjet e një) mujore, ndërkohë që referuar dokumentit “VËRTETIM PËR BAZËN E VLERËSUAR” datë 24.01.2026, i lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, ku nga institucioni shtetëror përgjegjës deklarohet se në periudhën kohore nga muaji janar 2012 e deri në muajin dhjetor 2025, ky punonjës ka derdhur kontributet mujore mbi bazën e pagës bruto për 152 (njëqind e pesëdhjet e dy) muaj, duke vërtetuar se ky punonjës ka qënë në marrdhënie pune për 152 (njëqind e pesëdhjet e dy) muaj, por pa deklaruar detyrën që ka ushtruar përgjatë kësaj periudhe kohore.

Për më tepër, Komisioni konstaton se komisioni i vlerësimit të ofertave për vlerësimin e këtij nënkriteri vlerësimi përsa i përket ofertës së operatorit ekonomik “DION-AL” SHPK ka marrë në shqyrtim vetëm dokumentacionin e dorëzuar për njërin nga 2 (dy) kryekuzhinierët e deklaruar dhe konkretisht dokumentacionin e znj. Ë. P (M), pasi sikurse konstatohet ky punonjës disponon më shumë vite eksperience pune si kuzhinier.

Nga analizimi i dokumentacionit të sipërpërmendur, Komisioni konstaton si në vijim: “Lidhur me eksperiencën e punës si “Kryekuzhinier” të z. D. D (i deklaruar si “Kryekuzhinier” pranë shoqërisë “4 S” SHPK) referuar dokumentit “VËRTETIM PËR BAZËN E VLERËSUAR” datë 24.01.2026, i lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore është dokument ligjor i cili vërteton vitet e punës që ka punuar ky punonjës, duke vërtetuar se ka punuar për një periudhë 96 (nëntëdhjet e gjashtë) mujore, por nuk vërteton që për këtë

periudhë të ketë kryer detyrën e “Kryekuzhinierit”; lidhur me eksperiencën e punës si “Kryekuzhinier” të znj. E. P (M), (e deklaruar si “Kryekuzhinier” pranë shoqërisë “DIONAL” SHPK) referuar dokumenti “Jetëshkrim (CV-i)”, dokument i cili nuk ka fuqi ligjore por është thjesht një vetëdeklarim i punonjësës nga ku deklarohet se në periudhat vjetore 1995 – 2011 dhe 2016 – e në vazhdim, ka ushtruar detyrën e “Kryekuzhinieres” për një periudhë 324 (treqind e njëzet e katër) mujore, ndërkohë që referuar dokumentit “Librezë pune”, cili është një dokument ligjor konstatohet se kjo punonjëse për periudhën kohore 1 janar 2013 – 1 tetor 2019 dhe 18 shkurt 2023 e në vazhdim, ka kryer detyrën e “Kuzhinieres” përkatësisht pranë shoqërisë “XXX” SHPK dhe shoqërisë “XXX” SHPK, duke rënë ndësh me deklaratimet e bëra në dokumentin “Jetëshkrim (CV-i)”, pasi për rreth 116 (njëqind e gjashtëmbëdhjetë) muaj të deklaruar në dokumentin “Jetëshkrim (CV-i)” referuar dokumentit “Librezë pune” ka kryer detyrën e “Kuzhinieres” dhe jo detyrën e “Kryekuzhinieres”, ndërsa referuar dokumentit “VËRTETIM PËR BAZËN E VLERËSUAR” datë 27.01.2026, i lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore është dokument ligjor i cili vërteton vitet e punës që ka punuar kjo punonjëse, duke vërtetuar se ka punuar për periudhën kohore nga muaji janar 2013 e deri në muajin dhjetor 2025, rreth 132 (njëqind e tridhjetë e dy) muaj, ku jonetëm nuk vërteton që për këtë periudhë të ketë kryer detyrën e “Kryekuzhinierit”, por bie ndesh me deklaratimet e bëra në dokumentin “Jetëshkrim (CV-i)”, pasi për rreth 192 (njëqind e nëntëdhjetë e dy) muaj të deklaruar në dokumentin “Jetëshkrim (CV-i)” referuar dokumentit “VËRTETIM PËR BAZËN E VLERËSUAR” datë 27.01.2026, i lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore nuk vërtetohet që të ketë kryer detyrën e “Kryekuzhinieres”; si dhe lidhur me eksperiencën e punës si “Kryekuzhinier” të z. S. H (i deklaruar si “Kryekuzhinier” pranë shoqërisë “DRIVE EXPERT ALBANIA” SHPK) SHPK referuar dokumenti “Jetëshkrim (CV-i)”, dokument i cili nuk ka fuqi ligjore por është thjesht një vetëdeklarim i punonjësës nga ku deklarohet se në periudhat vjetore nuk është deklaruar që të ketë kryer detyrën e “Kryekuzhinierit” dhe për më tepër referuar referuar dokumentit “VËRTETIM PËR BAZËN E VLERËSUAR” datë 24.01.2026, i lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore është dokument ligjor i cili vërteton vitet e punës që ka punuar ky punonjës, duke vërtetuar se ka punuar për një periudhë 152 (njëqind e pesëdhjetë e dy) mujore, por nuk vërteton që për këtë periudhë të ketë kryer detyrën e “Kryekuzhinierit”.”.

Nisur nga sa analizuar më sipër, Komisioni gjykon se dokumentacioni i vlefshëm ligjor për të vërtetuar vitet e marrdhënieve të punës është dokumenti “VËRTETIM PËR BAZËN E VLERËSUAR” i lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore nëpërmjet sistemit E-albania, ndërsa për periudhën kontributive përpara vitit 2012 merret pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore, ndërkohë që për të vërtetuar detyrën konkrete që ka kryer punonjësi gjatë periudhës kontributive dokumentacion ligjor që e vërteton është dokumenti “Librezë pune” dhe i cili lëshohet nga punëdhënësi i parë dhe është e posedim të punëmarrësit, si dhe dokumenti “Listëpagesa e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësim” i cili për periudhën kontributive nga viti 2012 e në vazhdim lëshohet nëpërmjet sistemit elektronik nga Drejtoria Rajonale Tatimore ndërsa për periudhën kontributive përpara vitit 2012 merret pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Nisur nga pretendimet e ankimuseve dhe nga sa më sipër, Komisioni gjykon se vlerësimi me pikë i nënkriterit të vlerësimit “Përvoja (Eksperienca) e kryekuzhinierit” nuk është bërë duke ju referuar periudhës kontributive gjatë të cilës vërtetohet me dokumentacion ligjor që

punonjësi i deklaruar që do të kryejnë detyrën e kryekuzhinierit të ketë kryer detyrën e “Kryekuzhinierit”, panvarësisht se në pikën 4.4 “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit” të Seksionit 4 “Procedura” të dokumenteve të tenderit të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt ankimi një nga dokumentat vërtetuese është përcaktuar dokumenti “Jetëshkrim (CV-i)”, dokument i cili jo vetëm nuk ka fuqi ligjore për të vërtetuar detyrën konkrete që ka kryer punonjësi, por për më tepër referuar analizimit të dokumentacionit të sipërpërmendur konstatohet se në rastin e punonjësit z. D. D (i deklaruar si “Kryekuzhinier” pranë shoqërisë “4 S” SHPK) me dokumentacionin e dorëzuar vërtetohet vetëm periudha kontributive e tij, ndërkohë që nuk vërtetohet detyra konkrete që ka kryer ky punonjës gjatë kësaj periudhe kontributive, ndërkohë që në rastin e punonjësës znj. È. P (M) deklarimet e bëra në dokumentin “Jetëshkrim (CV-i)” përsa i përket periudhës kontributive dhe detyrave që ka kryer gjatë periudhës kontributive, nuk përputhen me deklarimet e bëra në dokumentin “VËRTETIM PËR BAZËN E VLERËSUAR” përsa i përket periudhës kontributive dhe me dokumentin “Librezë pune” përsa i përket detyrave që ka kryer kjo punonjëse gjatë periudhës kontributive, ndërsa në rastin e punonjësit z. S. H deklarimet e bëra në dokumentin “Jetëshkrim (CV-i)” përsa i përket periudhës kontributive dhe detyrave që ka kryer gjatë periudhës kontributive, nuk përputhen me deklarimet e bëra në dokumentin “VËRTETIM PËR BAZËN E VLERËSUAR” përsa i përket periudhës kontributive dhe për më tepër përsa i përket detyrave që ka kryer gjatë periudhës kontributive.

Nisur nga sa parashtruar më sipër, Komisioni gjykon se komisioni i vlerësimit të ofertave nuk ka vlerësuar nënkriterin e vlerësimit “Përvoja (Eksperienca) e kryekuzhinierit” për ofertat e operatorëve ekonomik të kualifikuar “4 S” SHPK, “DION-AL” SHPK dhe “DRIVE EXPERT ALBANIA” SHPK, duke ju referuar periudhës kontributive dhe detyrës së “Kryekuzhinierit” të kryer gjatë kësaj periudhe kontributive nga punonjësit e sipërpërmendur dhe për më tepër dokumentacioni ligjor dhe deklarimet e bëra nga këta krijojnë indicie se këta persona mund të kenë kryer detyrën e “Kryekuzhinierit”, ndaj sipas përcaktimeve të nenit 92 pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe përcaktimeve të nenit 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar duhej të bënte verifikimet përkatëse pranë institucioneve për të identifikuar periudhën kontributive dhe detyrën konkrete që kanë kryer gjatë kësaj periudhe kontributive këta punonjës.

Nisur nga pretendimet e ankimesit, dokumentacionit të përmendur në pikën III.1.3., të këtij vendimi dhe përcaktimeve të autoritetit kontraktor të bëra në pikën 4.4 “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit” të Seksionit 4 “Procedura” të dokumenteve të tenderit të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt ankimi, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor duhet që të identifikojë saktë periudhën kontributive mujore gjatë se cilës personat e sipërpërmendur (të deklaruar se do të kryejnë detyrën e “Kryekuzhinierit”) kanë derdhur kontributet mujore mbi bazën e pagës bruto, si dhe të identifikojë saktë me dokumentacion ligjor detyrat që kanë kryer gjatë kësaj periudhe kontributive, për ti vendosur ofertuesit e kualifikuar në pozita të barabarta vlerësimi, duke verifikuar pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe pranë Drejtorive Rajonale Tatimore ku ushtrojnë aktivitetin këta ofertues periudhën kontributive dhe detyrën konkrete që kanë kryer gjatë kësaj periudhe kontributive nëpërmjet dokumentacionit ligjor të sipërpërmendur dhe vetëm pas këtij të bëjë rivlerësimin me pikë të nënkriterit të vlerësimit, duke i dhënë pikët maksimale (10 pikë) operatorit

ekonomik ofertues që disponon në stafin e tij punonjësin që do të kryejë detyrën e kryekuzhinierit, i cili me dokumentacion ligjor vërteton se për periudhën kontributive të vërtetuar ka kryer detyrën e “Kryekuzhinierit” për një periudhë mujore më të gjatë se punonjësit e deklaruar se do të kryejnë detyrën e kryekuzhinierit nga oferatorët e tjerë ofertues të kualifikuar, ndërkohë që operatorët e tjerë ekonomik të kualifikuar do të marrin pikët referuar periudhës mujore gjatë të cilës ka kryer detyrën e “Kryekuzhinierit” personi i deklaruar se do të kryejë detyrën e kryekuzhinierit, për periudhën kontributive të verifikuar dhe formulës përkatëse të publikuar në këtë seksion të dokumentave të tenderit të modifikuar.

Përsa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “4 S” SHPK qëndron pjesërisht.

III.1.18.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “4 S” SHPK përsa i përket vlerësimit me pikë të nënkriterit “*Kualifikimi profesional i kuzhinierit*” të ofertës së paraqitur prej tij, si dhe lidhur me pretendimet e tij për vlerësimin me pikë të ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë ofertues të kualifikuar “DION-AL” SHPK dhe “DRIVE EXPERT ALBANIA” SHPK, Komisioni referuar nënkriterit të vlerësimit të përcaktuar në pikën 4.4 “*Kriteret e përzgjedhjes së fituesit*” të Seksionit 4 “*Procedura*” të dokumenteve të tenderit të modifikuar të procedurës së prokurimit objekt ankimi, dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë të sipërpërmendur dhe të pasqyruar në pikën III.1.3., të këtij vendimi, si dhe procesverbalit të vlerësimit të ofertave të mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në datë 11.02.2026, konstatohet si më poshtë vijon:

- Operatori ekonomik i kualifikuar “4 S” SHPK për këtë nënkriter vlerësimi refruar Seksioni B: “*DEKLARATË ‘Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohet)’*” të Pjesës III: “*Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit*” të Shtojcës 10 “*FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT*” ka deklaruar se kryekuzhinier është znj. E. S, ku për të vërtetuar aftësitë profesionale që zotëron kjo e fundit ka dorëzuar gjithsej 3 (tre) certifikata ku nga shqyrtimi i Certifikatës Nr. Amzës: XXX, datë 29.03.2022, Certifikatës Nr. XXX, datë 26.08.2024 dhe Certifikatës Nr. XXX, datë 01.10.2025 konstatohet se kjo punonjëse zotëron gjithsej 21 (*njëzet e një*) kualifikime profesionale, përkatësisht si në vijim: “*Hyrje në profesionin e kuzhinierit; Përgatitja e buljonit dhe supave të thjeshta; Përgatitja e sallatave dhe antipastave; Përgatitja e asortimenteve të thjeshta me mish; Përgatitja e asortimenteve të thjeshta me peshk dhe me fruta deti; Përgatitja e brumërave; Siguria ushqimore; Teknologjitë ushqimore; Baza ligjore për OBU-t; Kërkesat e HACCP-it; Praktikat e mira të punës; PMP; Praktikat e mira të higjenes; PMH; Identifikimi dhe menaxhimi i pikave kritike të kontrollit në sigurinë ushqimore; Hartimi, implementimi, rregjistrimi; kontrolli i dokumentacionit HACCP në sektorë të ndryshëm ushqimor; Legjistacioni ushqimor në Shqipëri: Analizimi i risqeve të sigurisë ushqimore.”.*

- Operatori ekonomik i kualifikuar “DION-AL” SHPK për këtë nënkriter vlerësimi refruar Seksioni B: “*DEKLARATË ‘Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohet)’*” të Pjesës III: “*Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit*” të Shtojcës 10 “*FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT*” ka deklaruar se kuzhinier është znj. L. B ku për të vërtetuar aftësitë profesionale që zotëron kjo e fundit ka dorëzuar gjithsej 3 (tre) certifikata ku nga shqyrtimi i Certifikatës nr. Amzës: XXX, datën 13.01.2017,

Certifikatës Nr. XXX, datë 06.03.2025 dhe Certifikatës Certifikatë Nr. XXX, datë 13.03.2025 konstatohet se kjo punonjëse zotëron gjithsej 23 (njëzet e tre) kualifikime profesionale, përkatësisht si në vijim: *“Njohuri të përgjithshme mbi profesionin e kuzhinierit. Gatimet bazëe (Pjata e parë) sallata, salca, supa, kima, tasqebap, brumrat; Gatimi i mishrave; Gatimi i peshkut e prodhimeve të tjera të detit; Gatime nëe pritje, festa dhe ceremoni të tjera. Organizimi i punës në të tilla raste. Organizimi dhe ngritja e një ekonomie; Kuzhina tradicionale; 4 nivele e trajnimit HACCP (kategoritë, kush përfshihet dhe temat për secilin nivel); Niveli 1 - HACCP / Ndërgjegjësim për sigurinë ushqimore; Niveli 2 - Parimet HACCP / Siguria Ushqimore për Përpunuesit; Niveli 3 - HACCP i Ndërmjetëm / Mbikqyrës; Niveli 4 - HACCP i Avancuar / Menaxhere; Projektim i Sistemit HACCP; Zhvillimi i Analizës së Riskut; Kultura e sigurisë ushqimore dhe kërkesat ligjore; Hyrje në ISO 22000; Struktura e sistemit të menaxhimit të sigurisë ushqimore (FSMS), Zhvillimi i proceseve të sistemit të menaxhimit të sigurisë ushqimore; Programet parakushtuese (FPR); Pastrimi dhe higjena; Kontrrolli i dëmtuesve; Menaxhimi i furnizuesve; Higjena personale; Analiza e riskut dhe plani HACCP; Marrëdhënia me Codex HACCP, ISO 9001, FSSC 22000.”.*

- Operatori ekonomik i kualifikuar *“DRIVE EXPERT ALBANIA”* SHPK për këtë nënkriter vlerësimi refruar Seksioni B: *“DEKLARATË ‘Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohet)’”* të Pjesës III: *“Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit”* të Shtojcës 10 *“FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT”* ka deklaruar se kuzhinier është znj. N. M, ku për të vërtetuar aftësitë profesionale që zotëron kjo e fundit ka dorëzuar 1 (një) certifikatë ku nga shqyrtimi i Certifikatës nr. Amzës: XXX, datë 09.05.2023, e lëshuar nga nga Drejtoria Rajonale e Ofrimit Profesional Publik Nr. 4, Tiranë vërtetohet se z. S. H ka përfunduar kursin *“Kuzhinier”*, por nuk konstatohet se çfarë aftësishë profesionale ka fituar ky individ referuar kurrikulës apo programit mësimor që përfshin kjo certifikatë.

Referuar procesverbalit të vlerësimit të ofertave të mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në datë 11.02.2026, Komisioni konstaton se komisioni i vlerësimit të ofertave këtë kriter vlerësimi e ka bërë duke ju referuar numrit të certifikatave të dorëzuara nga ana e operatorëve ekonomikë ofertues të kualifikuar për punonjësin e deklaruar që do të kryejë rolin e kryekuzhinierit, ndërkohë që referuar analizës së këtij nënkriteri vlerësimi të parashtruar në pikën III.1.17., të këtij vendimi, Komisioni konstaton se vlerësimi i këtij kriteri nuk është bërë në përputhje me numrin e kualifikimeve profesionale që kanë përfituar punonjësit në rolin e kuzhinierit.

Nisur nga pretendimet e ankimesit dhe nga sa më sipër, Komisioni gjykon se vlerësimi me pikë i nënkriterit të vlerësimit *“Kualifikimi profesional i ekuzhinierit”* nuk është bërë duke ju referuar numrit të kualifikimeve profesionale të lidhura me profesionin e kuzhinierit dhe fushat ndihmëse (*ushqim, higjienë, siguri ushqimore, menaxhim kuzhine, planifikim menuje, etj.*) që disponojnë punonjësit e deklaruar që do të kryejnë detyrën e kuzhinierit, sikurse është përcaktuar në pikën 4.4 *“Kriteret e përzgjedhjes së fituesit”* të Seksionit 4 *“Procedura”* të dokumenteve të tenderit të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Për më tepër, nisur nga fakti se Certifikata nr. Amzës: XXX, lëshuar në datën 09.05.2023, nga Drejtoria Rajonale e Ofrimit Profesional Publik Nr. 4, Tiranë vërteton se mbajtësi i kësaj certifikate zotëron aftësitë profesionale lidhur me kryerjen e profesionit të kuzhinierit, por në këtë certifikatë nuk është e mundur që të identifikohen se çfarë lloj aftësish profesionale kanë përfituar mbajtësit e kësaj certifikate.

Nisur nga sa parashtruam më sipër, Komisioni gjykon se komisioni i vlerësimit të ofertave nuk ka vlerësuar nënkriterin e vlerësimit *“Kualifikimi profesional i kuzhinierit”* për ofertat e operatorëve ekonomik të kualifikuar *“4 S” SHPK, “DION-AL” SHPK dhe “DRIVE EXPERT ALBANIA” SHPK*, duke ju referuar numrit të kualifikimeve profesionale të lidhura me profesionin e kuzhinierit dhe fushat ndihmëse (*ushqim, higjienë, siguri ushqimore, menaxhim kuzhine, planifikim menuje, etj.*) të punonjësve të deklaruar që do të kryejnë detyrën e kuzhinierit në rast se shpallen fitues, si dhe komisioni i vlerësimit të ofertave nisur nga fakti se Certifikata nr. Amzës: XXX, lëshuar në datën 09.05.2023, nga Drejtoria Rajonale e Ofrimit Profesional Publik Nr. 4, Tiranë vërteton se punonjësi mbajtës i kësaj certifikate ka aftësitë profesionale për të kryer detyrën e kuzhinierit, duke krijuar indicie se ky person kanë një numër të caktuar kualifikimesh profesionale referuar kurrikulës apo programit mësimor të ndjekur, ndaj duhej që sipas përcaktimeve të nënit 92 pika 1 të ligjit nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar dhe përcaktimeve të nenit 82 *“Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”* të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar të bënte verifikimet përkatëse pranë institucioneve për të identifikuar numrin e aftësive profesionale që ka përfutuar ky punonjës.

Nisur nga pretendimet e ankimesit, dokumentacionit të përmendur në pikën III.1.3., të këtij vendimi dhe përcaktimeve të autoritetit kontraktor të bëra në pikën 4.4 *“Kriteret e përzgjedhjes së fituesit”* të Seksionit 4 *“Procedura”* të dokumenteve të tenderit të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt ankimi, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor duhet që të identifikojë numrin e kualifikimeve që ka përfutuar mbajtësi i Certifikatës nr. Amzës: 1980, lëshuar në datën 09.05.2023, nga Drejtoria Rajonale e Ofrimit Profesional Publik Nr. 4, Tiranë, duke verifikuar kurrikulat ose programin mësimorë të përvetësuar dhe mbi bazën e të cilit është lëshuar kjo certifikatë dhe pasi të identifikojë numrin e kualifikimeve që zotëron secili prej punonjësve të deklaruar që do të kryejnë punën e kuzhinierit për secilin nga operatorët ekonomikë ofertues të kualifikuar, atëherë të bëjë rivlerësimin me pikë për këtë nënkriter vlerësimi, duke i dhënë pikët maksimale (5 pikë) operatorit ekonomik ofertues që disponon në stafin e tij punonjës in që do të kryejë detyrën e kuzhinierit dhe që zotëron numrin më të madhë të kualifikimeve profesionale, ndërkohë që operatorët e tjerë ekonomik të kualifikuar do të marrin pikët referuar numrit të kualifikimeve të kërkuara që ka personi me detyrën *“Kuzhinier”* që disponon në stafin e tij dhe formulës përkatëse të publikuar në këtë seksion të dokumentave të tenderit të modifikuara.

Përsa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes *“4 S” SHPK* qëndron pjesërisht.

III.1.18.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes *“4 S” SHPK* përsa i përket vlerësimit me pikë të nënkriterit *“Përvoja (Eksperienca) e kuzhinierit”* të ofertës së paraqitur prej tij, si dhe lidhur me pretendimet e tij për vlerësimin me pikë të ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë ofertues të kualifikuar *“DION-AL” SHPK dhe “DRIVE EXPERT ALBANIA” SHPK*, Komisioni referuar nënkriterit të vlerësimit të përcaktuar në pikën 4.4 *“Kriteret e përzgjedhjes së fituesit”* të Seksionit 4 *“Procedura”* të dokumenteve të tenderit të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt ankimi, dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë të sipërpërmendur dhe të pasqyruar në pikën III.1.3., të këtij vendimi,

si dhe procesverbalit të vlerësimit të ofertave të mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në datë 11.02.2026, konstatohet si më poshtë vijon:

- Operatori ekonomik i kualifikuar “4 S” SHPK për këtë nënkriter vlerësimi refruar Seksioni B: “*DEKLARATË ‘Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohet)’*” të Pjesës III: “*Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit*” të Shtojcës 10 “*FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT*” ka deklaruar se kuzhinier ëshë znj. E. S, ku për të vërtetuar eksperiencën në punë kjo e fundit ka dorëzuar dokumentin “*VËRTETIM PËR BAZËN E VLERËSUAR*” datë 27.01.2026 të lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore ku identifikohet se ka derdhur kontributet mujore mbi bazën e pagës bruto për 101 (*njëqind e një*) muaj, në periudhën e punësimit nga muaji shkurt 2016 deri në muajin dhjetor 2025.

- Operatori ekonomik i kualifikuar “DION-AL” SHPK për këtë nënkriter vlerësimi refruar Seksioni B: “*DEKLARATË ‘Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohet)’*” të Pjesës III: “*Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit*” të Shtojcës 10 “*FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT*” ka deklaruar se kuzhinier është znj. L. B, ku për të vërtetuar eksperiencën në punë kjo e fundit ka dorëzuar dokumentin “*VËRTETIM PËR BAZËN E VLERËSUAR*” datë 29.01.2026 të lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore ku identifikohet se ka derdhur kontributet mujore mbi bazën e pagës bruto për 138 (*njëqind e tridhjetë e tetë*) muaj, në periudhën e punësimit nga muaji janar 2012 deri në muajin dhjetor 2025, dokumentin “*Jetëshkrim (CV-i)*” ku deklaroi se ka punuar me detyrën e kuzhinierit për 60 (*gjashtëdhjetë*) muaj, si dhe dokumentin “*Librezë pune*” sipas formatit të miratuar nga Instituti i Sigurive Shoqërore për punëmarrësin znj. L. B, të lëshuar nga punëdhënësi “XXX” SHPK, ku deklarohet se për 70 (*shtatëdhjetë*) muaj ka punuar me detyrën e kuzhinieres.

- Operatori ekonomik i kualifikuar “DRIVE EXPERT ALBANIA” SHPK për këtë nënkriter vlerësimi refruar Seksioni B: “*DEKLARATË ‘Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohet)’*” të Pjesës III: “*Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit*” të Shtojcës 10 “*FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT*” ka deklaruar se kuzhinier ëshë znj. N. M, ku për të vërtetuar eksperiencën në punë kjo e fundit ka dorëzuar dokumentin dokumentin “*Librezë pune*” sipas formatit të miratuar nga Instituti i Sigurive Shoqërore për punëmarrësin znj. Nevila Mollaymeri, të lëshuar nga punëdhënësi Komuna Kote, ku deklarohet se për 46 (*dyzet e gjashtë*) muaj ka punuar me detyrën e kuzhinieres.

Referuar procesverbalit të vlerësimit të ofertave të mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në datë 11.02.2026, Komisioni konstaton se komisioni i vlerësimit të ofertave vlerësimin e këtij nënkriteri në rastin e ofertës së operatorit ekonomik “4 S” SHPK e ka bërë duke ju referuar dokumentit “*VËRTETIM PËR BAZËN E VLERËSUAR*” datë 27.01.2026 të lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, ku anëtarët e komisioni të vlerësimit të ofertave kanë konsideruar si muaj eksperience periudhën kohore gjatë së cilës ky punonjës ka punuar pranë shoqërisë “4 S” SHPK, si dhe periudhën kohore nga data 29.03.2022 (*data e lëshimit të Certifikatës Nr. Amzës: XXX, datë 29.03.2022*) deri në fund të muajit dhjetor 2025, duke konkluduar se nga 101 (*njëqind e një*) muaj eksperiencë pune znj. E. S ka eksperiencë pune si kuzhinier një periudhë prej 26 (*njëzet e gjashtë*) muaj (*periudha kohore gjatë së cilës ka punuar pranë shoqërisë “4 S” SHPK dhe njëkohësisht është pajisur me Certifikatës Nr. Amzës: XXX, datë 29.03.2022, duke supuzuar se periudha kohore nga data e pajisjes me*

certifikatën profesionale e në vazhdim do të konsiderohet si eksperiencë pune në detyrën e “Kuzhibieres”), ndërsa në rastin e ofertës së operatorit ekonomik “DION-AL” SHPK vlerësimin e këtij nënkriteri e ka bërë duke ju referuar dokumentave “VËRTETIM PËR BAZËN E VLERËSUAR”, “Jetëshkrim (CV-i)” dhe “Librezë pune”, duke konstatuar se znj. Ludjana Bonaj ka eksperiencë pune si kuzhinierë një periudhë prej 156 (njëqind e pesëdhjet e gjashtë) muaj, ndërkohë që në rastin e ofertës së operatorit ekonomik “DRIVE EXPERT ALBANIA” SHPK vlerësimin e këtij nënkriteri e ka bërë duke ju referuar dokumentit “Librezë pune”, duke konstatuar se znj. N. Mi ka eksperiencë pune si kuzhinier një periudhë prej 46 (dyzet e gjashtë) muaj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të përmendur në pikën III.1.3., të këtij vendimi, Komisioni konstaton, si më poshtë:

- Punonjësja znj. E. S (e deklaruar si “Kuzhinierë” pranë shoqërisë “4 S” SHPK) për të vërtetuar përvojën në punë si kuzhinierë ka dorëzuar dokumentin “VËRTETIM PËR BAZËN E VLERËSUAR” datë 27.01.2026, i lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, ku nga institucioni shtetëror përgjegjës deklarohet se në periudhën kohore nga muaji shkurt 2016 e deri në muajin dhjetor 2025, kjo punonjëse ka derdhur kontributet mujore mbi bazën e pagës bruto për 101 (njëqind e një) muaj, duke vërtetuar se ky punonjës ka qënë në marrdhënie pune për 101 (njëqind e një) muaj, por pa deklaruar detyrën që ka ushtruar përgjatë kësaj periudhe kohore.

- Punonjësja znj. L. B, (e deklaruar si “Kuzhinierë” pranë shoqërisë “DION-AL” SHPK) për të vërtetuar përvojën në punë si kuzhinierë ka dorëzuar dokumentin “Jetëshkrim (CV-i)”, i cili është një vetëdeklarim i punonjësës znj. Ludjana Bonaj, e cila deklaron se për periudhat vjetore 2012-2016; 2017 – 2019; 2017 – 2025 dhe 2023 - 2024 ka ushtruar profesionin duke kryer detyrën e “Kuzhinierës” për një periudhë 36 (tridhjetë e gjashtë) mujore pranë shoqërisë “XXX” SHPK dhe shoqërisë “XXX” SHPK për periudhën kohore 2017 – 2019, detyrën e “Kuzhinierë” për një periudhë 24 (njëzet e katër) muaj pranë shoqërisë “XXX” SHPK dhe shoqërisë “XXX” SHPK për periudhën kohore 2023 – 2024, si dhe detyrën e “Kuzhinierë” për një periudhë 60 (gjashtëdhjetë) muaj pranë shoqërisë “XXX” SHPK për periudhën kohore 2020 – 2023 dhe 2025 e në vazhdim, ndërkohë që referuar dokumentit “Librezë pune” deklarohet se për periudhat kohore 24 shkurt 2017 - 13 korrik 2017 dhe 02 shkurt 2019 - 09 tetor 2019 ka ushtruar profesionin duke kryer detyrën e “Kuzhinierit” pranë shoqërisë “XXX” SHPK për 15 (pesëmbëdhjetë) muaj, ndërsa për periudhat kohore 10 tetor 2019 - 10 gusht 2020; 08 tetor 2020 - 22 maj 2023 dhe 03 dhjetor 2024 e në vazhdim ka ushtruar profesionin duke kryer detyrën e “Kuzhinierit” pranë shoqërisë “DION-AL” SHPK për 55 (pesëdhjet e pesë) muaj, si dhe referuar dokumentit “VËRTETIM PËR BAZËN E VLERËSUAR” datë 29.01.2026, i lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, ku nga institucioni shtetëror përgjegjës deklarohet se në periudhën kohore nga muaji janar 2012 e deri në muajin dhjetor 2025, kjo punonjëse ka derdhur kontributet mujore mbi bazën e pagës bruto për 138 (njëqind e tridhjetë e tetë) muaj, duke vërtetuar se kjo punonjëse ka qënë në marrdhënie pune për 138 (njëqind e tridhjetë e tetë) muaj, por pa deklaruar detyrën që ka ushtruar përgjatë kësaj periudhe kohore.

- Punonjësi znj. N. M, (e deklaruar si “Kuzhinier” pranë shoqërisë “DRIVE EXPERT ALBANIA” SHPK) për të vërtetuar përvojën në punë si kuzhinier referuar dokumentit “Librezë pune” deklarohet se për periudhën kohore 05 mars 2022 e në vazhdim ka ushtruar

profesionin duke kryer detyrën e “Kuzhinierit” pranë shoqërisë “DRIVE EXPERT ALBANIA” SHPK për 46 (dyzet e gjashtë) muaj,

Nga analizimi i dokumentacionit të sipërpërmendur, Komisioni konstaton si në vijim: “Lidhur me eksperiencën e punës si “Kuzhinier” të znj. E. S (i deklaruar si “Kuzhinier” pranë shoqërisë “4 S” SHPK) referuar dokumentit “VËRTETIM PËR BAZËN E VLERËSUAR” datë 27.01.2026, i lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore është dokument ligjor i cili vërteton vitet e punës që ka punuar ky punonjës, duke vërtetuar se ka punuar për një periudhë 101 (njëqind e një) muaj, por nuk vërteton që për këtë periudhë të ketë kryer detyrën e “Kuzhinierit”; lidhur me eksperiencën e punës si “Kuzhinier” të znj. Ludjana Bonaj, (e deklaruar si “Kuzhinier” pranë shoqërisë “DION-AL” SHPK) referuar dokumenti “Jetëshkrim (CV-i)”, dokument i cili nuk ka fuqi ligjore por është thjesht një vetëdeklarim i punonjës nga ku deklarohet se në periudhat vjetore 2020 – 2022 dhe 2025 e në vazhdim ka ushtruar detyrën e “Kuzhinieres” për një periudhë 48 (dyzet e tetë) mujore pranë kompanisë “XXX” SHPK, për periudhën vjetore 2017-2019 ka ushtruar detyrën e “Kuzhinieres” për një periudhë 36 (tridhjetë e gjashtë) mujore pranë kompanisë “XXX” SHPK dhe pranë kompanisë “XXXI” SHPK, për periudhën vjetore 2023 - 2024 ka ushtruar detyrën e “Kuzhinieres” për një periudhë 24 (njëzet e katër) mujore pranë kompanisë “XXX” SHPK dhe pranë kompanisë “XXX” SHPK dhe për periudhën vjetore 2012 - 2016 ka ushtruar detyrën e “Kuzhinieres” për një periudhë 60 (gjashtë dhjetë) mujore pranë XXX, ndërkohë që referuar dokumentit “Librezë pune”, i cili është një dokument ligjor konstatohet se kjo punonjëse për periudhën kohore nga data 24 shkurt 2017 deri në datën 13 korrik 2017 ka kryer detyrën e “Kuzhinieres” për një periudhë 6 (gjashtë) mujore pranë kompanisë “XXX” SHPK, nga data 02 shkurt 2019 deri në datën 09 tetor 2019 ka kryer detyrën e “Kuzhinieres” për një periudhë 9 (nëntë) mujore pranë kompanisë “XXX” SHPK, nga data 10 tetor 2019 deri në datën 10 gusht 2020 ka kryer detyrën e “Kuzhinieres” për një periudhë 10 (dhjetë) mujore pranë kompanisë “XXX” SHPK, nga data 08 tetor 2020 deri në datën 22 maj 2023 ka kryer detyrën e “Kuzhinieres” për një periudhë 32 (tridhjetë e dy) mujore pranë kompanisë “XXX” SHPK dhe nga data 03 dhjetor 2024 e në vazhdim ka kryer detyrën e “Kuzhinieres” për një periudhë 13 (trembëdhjetë) mujore pranë kompanisë “XXX” SHPK, duke rënë ndësh me deklaratimet e bëra në dokumentin “Jetëshkrim (CV-i)”, në të cilin ka deklaruar se 37 (tridhjetë e shtatë) muaj të periudhës kohore si në vijim: “Janar 2017; gusht 2017 – janar 2019; shtator 2020 dhe qershor 2023 – nëntor 2024.”, ku ka qënë e punësuar pranë kompanisë “XXX” SHPK dhe për rreth 60 (gjashtëdhjetë) muaj të periudhës kohore si në vijim: “Viti 2012 – viti 2016”, ku ka punuar pranë XXX, deklaratime të cilat bien ndesh me deklaratimet e bëra nga punëdhënesi në dokumentin “Librezë pune”, ku për këta muaj punësimi nuk rezultojnë të pasqyruar në këtë dokument si periudhë punësimi me detyrën e “Kuzhinier”, ndonëse figurojnë të pasqyruara në dokumentin “VËRTETIM PËR BAZËN E VLERËSUAR” datë 29.01.2026 i lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore; si dhe lidhur me eksperiencën e punës si “Kuzhinier” të znj. N. M (e deklaruar si “Kuzhinier” pranë shoqërisë “DRIVE EXPERT ALBANIA” SHPK) referuar dokumentit “Librezë pune” i cili është një dokument ligjor, i cili vërteton se kjo punonjëse për periudhën kohore 05 mars 2022 e në vazhdim ka kryer detyrën e “Kuzhinier” pranë shoqërisë “DRIVE EXPERT ALBANIA” SHPK për 46 (dyzet e gjashtë) muaj.”.

Nisur nga sa analizuar më sipër, Komisioni gjykon se dokumentacioni i vlefshëm ligjor për të vërtetuar vitet e marrdhënieve të punës është dokumenti “*VËRTETIM PËR BAZËN E VLERËSUAR*” i lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore nëpërmjet sistemit E-albania, ndërsa për periudhën kontributive përpara vitit 2012 merret pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore, ndërkohë që për të vërtetuar detyrën konkrete që ka kryer punonjësi gjatë periudhës kontributive dokumentacion ligjor që e vërteton është dokumenti “Librezë pune” dhe i cili lëshohet nga punëdhënësi i parë dhe është e posedim të punëmarrësit, si dhe dokumenti “*Listëpagesa e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësim*” i cili për periudhën kontributive nga viti 2012 e në vazhdim lëshohet nëpërmjet sistemit elektronik nga Drejtoria Rajonale Tatimore ndërsa për periudhën kontributive përpara vitit 2012 merret pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Nisur nga pretendimet e ankimuseit dhe nga sa më sipër, Komisioni gjykon se vlerësimi me pikë i nënkriterit të vlerësimit “*Përvoja (Eksperienca) e kuzhinierit*” nuk është bërë duke ju referuar periudhës kontributive gjatë të cilës vërtetohet me dokumentacion ligjor që punonjësi i deklaruar që do të kryejnë detyrën e kuzhinierit të ketë kryer detyrën e “*Kuzhinierit*” panvarësisht se në pikën 4.4 “*Kriteret e përzgjedhjes së fituesit*” të Seksionit 4 “*Procedura*” të dokumenteve të tenderit të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt ankimi një nga dokumentat vërtetuese është përcaktuar dokumenti “*Jetëshkrim (CV-i)*”, dokument i cili jo vetëm nuk ka fuqi ligjore për të vërtetuar detyrën konkrete që ka kryer punonjësi, por për më tepër referuar analizimit të dokumentacionit të sipërpërmendur konstatohet se në rastin e punojësës znj. E. S (e deklaruar si “*Kuzhinier*” pranë shoqërisë “*4 S*” SHPK) me dokumentacionin e dorëzuar vërtetohet vetëm periudha kontributive e saj, ndërkohë që nuk vërtetohet detyra konkrete që ka kryer ky punonjës gjatë kësaj periudhe kontributive, ndërkohë që në rastin e punojësës znj. L. B deklarimet e bëra në dokumentin “*Jetëshkrim (CV-i)*” përsa i përket periudhës kontributive dhe detyrave që ka kryer gjatë periudhës kontributive, nuk përputhen me deklarimet e bëra në dokumentin “*Librezë Pune*” përsa i përket detyrave që ka kryer kjo punonjëse gjatë periudhës kontributive.

Nisur nga sa parashtruar më sipër, Komisioni gjykon se komisioni i vlerësimit të ofertave nuk ka vlerësuar nënkriterin e vlerësimit “*Përvoja (Eksperienca) e kuzhinierit*” për ofertat e operatorëve ekonomik të kualifikuar “*4 S*” SHPK dhe “*DION-AL*” SHPK, duke ju referuar periudhës kontributive dhe detyrës së “*Kuzhinierit*” të kryer gjatë kësaj periudhe kontributive nga punonjësit e sipërpërmendur dhe për më tepër dokumentacioni ligjor dhe deklarimet e bëra nga këta krijojnë indicie se këta persona mund të kenë kryer detyrën e “*Kuzhinierit*”, ndaj sipas përcaktimeve të nënit 92 pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar dhe përcaktimeve të nënit 82 “*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar duhej të bënte verifikimet përkatëse pranë institucioneve për të identifikuar periudhën kontributive dhe detyrën konkrete që kanë kryer gjatë kësaj periudhe kontributive këta punonjës.

Nisur nga pretendimet e ankimuesit, dokumentacionit të përmendur në pikën III.1.3., të këtij vendimi dhe përcaktimeve të autoritetit kontraktor të bëra në pikën 4.4 “*Kriteret e përzgjedhjes së fituesit*” të Seksionit 4 “*Procedura*” të dokumenteve të tenderit të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt ankimi, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor duhet që të identifikojë saktë periudhën kontributive mujore gjatë se cilës personat

e sipërpërmendur (të deklaruar se do të kryejnë detyrën e “Kuzhinierit”) kanë derdhur kontributet mujore mbi bazën e pagës bruto, si dhe të identifikojë saktë me dokumentacion ligjor detyrat që kanë kryer gjatë kësaj periudhë kontributive, për ti vendosur ofertuesit e kualifikuar në pozita të barabarta vlerësimi, duke verifikuar pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe pranë Drejtorive Rajonale Tatimore ku ushtrojnë aktivitetin këta ofertues periudhën kontributive dhe detyrën konkrete që kanë kryer gjatë kësaj periudhë kontributive nëpërmjet dokumentacionit ligjor të sipërpërmendur dhe vetëm pas këtij të bëjë rivlerësimin me pikë të nënkriterit të vlerësimit, duke i dhënë pikët maksimale (5 pikë) operatorit ekonomik ofertues që disponon në stafin e tij punonjësish që do të kryejnë detyrën e kryekuzhinierit, i cili me dokumentacion ligjor vërteton se për periudhën kontributive të vërtetuar ka kryer detyrën e “Kuzhinierit” për një periudhë mujore më të gjatë se punonjësish e deklaruar se do të kryejnë detyrën e kryekuzhinierit nga ofertuesit e tjerë ofertues të kualifikuar, ndërkohë që operatorët e tjerë ekonomik të kualifikuar do të marrin pikët referuar periudhës mujore gjatë të cilës ka kryer detyrën e “Kuzhinierit” personi i deklaruar se do të kryejnë detyrën e kryekuzhinierit, për periudhën kontributive të verifikuar dhe formulës përkatëse të publikuar në këtë seksion të dokumentave të tenderit të modifikuar.

Përsa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes “4 S” SHPK qëndron pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “4 S” SHPK në procedurën e prokurimit *E hapur mbi kufirin e lartë monetar*, me numër reference Nr. REF-67406-10-31-2025, me objekt: “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Njësinë Speciale për Kufirin dhe Emigracionin”, me fond limit 119.232.710 (njëqind e njëmbëdhjet million e dyqind e tridhjet e dy mijë e shtatëqind e dhjetë) lekë pa TVSH ose 1.231.361,25 (një million e dyqind e tridhjet e një mijë e treqind e gjashtëdhjet e një presje njëzet e pesë) euro pa TVSH, Loti 1, me numër reference Nr. REF-67408-10-31-2025, me objekt të lotit: “Gatim dhe shpërndarje ushqimi për Njësinë e Sigurisë Publike Tiranë” me fond limit të lotit 76.903.340 (shtatëdhjetë e shtatë million e nëntëqind e tre mijë e treqind e dyzet) lekë pa TVSH ose 794.209,85 (shtatëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e dyqind e nëntë presje tetëdhjet e pesë) euro pa

TVSH, zhvilluar me datë 30.01.2026, nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara SHA.

2. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi në përputhje me konstatimet e këtij vendimi.
 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “4 S” ShPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

